



Koha

www.koha.mk

**Urime 28 Nëntori
Dita e Flamurit**

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3232 · e martë-e mërkurë 28-29 nëntor 2017

-7°C | +2°C

15 DEN

EDITORIAL

Ikja nga qendra



Bërja e punëve shkel e shko, është një nga shumë karakteristikat negative të përfaqësuesve të shoqërisë shqiptare edhe në Maqedoni. Vetëm ndër ne çështjet e rëndësishme trajtohen në mënyrë euforike, pa analizë e plan paraprak. Mbase, kjo është dëshmuar me qindra e qindra herë. Shkupi historikisht ka qenë qendër e shqiptarëve. Nëse në te kaluarën regjimi komunist ka realizuar projekte të shumta për...

Fq.2

RAJON

Shqiptarët konsumatorët më të mëdhenj të kokainës

Fq.14

GLOBI

Dhjetë ditë kohë më shumë për britanikët

Fq.15



SHËNDETËSIA, NYJA E PAZGJIDHUR E PARTNERËVE QEVERTAR

"LUFTË" PËR POZICIONE TË FORTA

ASH mbetet në pozicionin që të mbajnë Shëndetësinë dhe nëse jo - kjo parti kërkon nga LSDM të lëshojë Ministrinë e Arsimit, atë të Punës dhe Politikës Sociale, apo edhe të Transportit plus një ministër pa resor, kjo për të kompensuar uljen e pozicionit politik në Qeveri. Nga BDI janë të sigurt se Shëndetësia do t'i merret ASH-së dhe pak rëndësi do të ketë nëse atë do ta merr kjo parti apo LSDM



Fq.3

**libri i
artë**
2017/18

**KOPJE
FALAS**
me gazetën Koha
më 2 Dhjetor
(e shtunë)



EDITORIAL

IKJA NGA QENDRA



Shkëlzen HALIMI

Bërja e punëve shkel e shko, është një nga shumë karakteristikat negative të përfaqësuesve të shoqërisë shqiptare edhe në Maqedoni. Vetëm ndër ne çështjet e rëndësishme trajtohen në mënyrë euforike, pa analizë e plan paraprak. Mbase, kjo është dëshmuar me qindra e qindra herë.

Shkupi historikisht ka qenë qendër e shqiptarëve. Nëse në te kaluarën regjimi komunist ka realizuar projekte të shumta për pastrimin e kësaj qendra nga shqiptarët, në periudhën post-komuniste, vetë shqiptarët kanë kontribuar që ta vrasin indin e qenies së tyre, që ndër shekuj i ka bërë ballë sfidave të shumta.

Ikja nga qendra filloi pikërisht me formimin e partisë së parë shqiptare, pastaj partisë së dytë, së tretë e kështu me radhë, të cilat selitë e tyre i përqendruan në Tetovë, në vend se në Shkup, ku janë të koncentruar të gjitha institucionet shtetërore. Atëbotë, tendencat e këtuja u shprehën edhe në kulturë, ekonomi dhe arsim, duke i hapur rrugën e dominimit të irracionales mbi racionalen.

Strategjia e ruajtjes së Shkupit nga ndikimi i faktorit shqiptar, u implementua edhe me hapjen e dy universiteteve shqiptare larg Shkupit, që ka qenë kusht kryesor për t'ua "dhënë këtë të drejtë" shqiptarëve, të cilët, fatkeqësisht, janë bërë "ekspertë" për t'i kërkuar edhe të drejtat e natyrshe, për të cilat absolutisht nuk ka nevojë për të trokitur në asnjë derë.

Nuk është fshehtësi, por në një moment pati përpjekje që edhe selia e BFI-së të zhvendoset në Tetovë, jo që këtë qytet ta bëjnë qendër të shqiptarëve, por thjeshtë Shkupin ta pastrojnë dhe ta groposin historinë e lavdishme shumë-shkulllore të shqiptarëve, mbi të cilën ka kohë shkruhet historia maqedonase.

Edhe paralajmërimi i themelimit të Ansambli shtetëror shqiptar në Tetovë, ndonëse kanë filluar të shprehën edhe mendime që diçka e tillë duhet të jetësohet në qytete tjera me shumicë shqiptare, për shumë arsye nuk do ta kishin as për së afërmi peshën me selinë e këtij Ansambli në Shkup. Pra, kultura duhet të përçohet nga Shkupi, ngjashëm sikur krijohen rrathët koncentrik kur hedhet guri në një sipërfaqe të gjerë të ujit.

Mbase, në Shkup është e gjithë infrastruktura e nevojshme për zhvillimin e një kulture të mirëfilltë shqiptare. Nëse vazhdojmë me avazin e ikjes nga qendra dhe koncentrimi në periferi, atëherë vërtet gjithçka do të jetë periferike, për të mos thënë provinciale.

Ndaj, nuk duhet që të lejojmë që pa na detyruar askush, vullnetarisht ta mohojmë historinë shqiptare të Shkupit...

KOSOVA E FUNDIT

"Strategjia e re e zgjerimit e BE-se, do të publikohet në shkurt. Në këtë fazë, parashikon si më poshtë: Anëtarësim dhe përshejtim të rrugës për Serbinë dhe Malin e Zi; Rekomandim të plotë për Maqedoninë dhe Shqipërinë (do të fillojnë negociatat në vitin 2018); Rekomandim për statusin e kandidatit për Bosnjën nëse plotësohen disa kriteret të ndërlidhura me reformat kushtetuese; E për Kosovën shumë pak flitet. BE ende nuk ka gjet rekomandimin e duhur. Spanja pengon perspektivën e qartë evropiane për Kosovën. Shumë në Bruksel presin që Kosova të fillojë pre-screening për kapituj 23 dhe 24, në fushën e rendit dhe ligjit, por nuk parashihet ndonjë formulim i qartë. Nëse ndodh kështu, Kosova do të pësojë shumë... Gjithçka më pak se perspektiva e aplikimit për statusin e kandidatit për anëtarësim, do të jetë shumë e mangët", shkruan në FB, analisti Naim Rashiti.

PRISHTINA, NJË KRYEQYTET EVROPIAN

"Urime Shpend Ahmetit për katër vitet e ardhshme në krye të Prishtinës. VV-AKR së bashku do të punojnë në realizimin e projekteve të mëdha dhe të shndërrojme Prishtinën në një kryeqytet evropian", ka shkruar Rrahim Pacolli i AKR-së në Facebook.

KOKAT E PRERA DHE THIRRJET E STAVILECIT

"Shpallja e VV si organizatë terroriste është thirrje dhe tentim për përmbysje të demokracisë së brishtë të Kosovës. është thirrje për eliminim të kundërshtarit politik e cila nxjerrë pasojë tragjike dhe katastrofale. Nuk duhet të habitemi nëse një ditë Stavileci del me një vendim për të na lajmëruar se është i lejuar (pa gjyq) edhe ekzekutimi i anëtarëve të VV. Stavileci është në pritje të kësaj situatë të cilës ai i gëzohet. Ai është duke pritur që qytetarët e Kosovës të dalin në gjah për prerjen e kokave të anëtarëve të VV. Ai pret që ne me duar të përgjakura të shkojmë te ai, te zyra e partisë së tij dhe te shteti i tij për t'i dorëzuar kokat e prera dhe për të marrë shpërblimin. Por, thirrja e Stavilecit nuk do të realizohet edhe ai mendon që ka përkrahje në disa media anti shqiptare dhe nga shumë idiotët të mediave sociale. Kosova, edhe pse duket e shkërdhyer nga klani dhe shteti i Stavilecit, ende ka njerëz që e kanë ruajtur mendjen, moralin, ndjenjën njerëzore dhe dashurinë për vendin.", shkruan publicisti Daut Dauti në FB.

TË ZBARDHET SULMI NDAJ DY SERBËVE TË FSK-SË

"Është i papranueshëm sulmi mbi shtëpitë e dy pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Zubin Potok. Kërkoj nga Policia e Kosovës që ta zbardhin rastin dhe përgjegjësit t'i sjellin sa më shpejtë para drejtësisë. Ne jemi të përkushtuar në integrimin e plotë të komunitetit serb dhe pakicave të tjera në institucionet e Kosovës", shkruan në profilin e tij në FB, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi.

MEDIACitate

Zëvendëskryeministri i Republikës së Turqisë, Hakan Çavushoglu, deklaroi se është e pamundur të vendoset paqja globale derisa ajo nuk jetësohet në Ballkan. "Mos harroni se Ballkani është vendi ku një shkëndijë dhe një pishtar i ndezur shpërthyen dy luftëra botërore. Çdo kanosje e paqes dhe qetësisë në Ballkan është kërcënim i madh për mbarë botën. Qëndrimi ynë është se të gjithë vëllezërit tanë në këtë rajon duhet të jetojnë në pajtim me të gjitha të drejtat dhe liritë", theksoi Çavushoglu gjatë adresimit në një tubim në Bursa. Duke rikujtuar se dje u shënuar Dita Ndërkombëtare e Luftës Kundër Dhunës ndaj Grave, ai me këtë rast porositi se të gjitha format e dhunës dhe diskriminimit mbi gratë janë të papranueshme. Duke vënë në dukje se Turqia mbron unitetin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me vendet e Ballkanit, Çavushoglu tha se pas krijimit të unitetit dhe bashkimit në Turqi, e njëjta gjë nevojitet edhe në vendet e Ballkanit.

(Anadolu Agency, 27 nëntor)

Ëndrra e mbretit të Serbisë, Stefan Dushan, për të dalë në Portin e Durrësit po bëhet realitet pas rreth 660 vjetësh, por kësaj radhe jo me luftë, por përmes "Autostradës së paqes" Nish-Merdar-Prishtinë-Durrës. Ministri serb i Ekonomisë, Goran Knezeviq, deklaroi në fundjavë në Tiranë se projekti për ndërtimin e autostradës Nish-Merdar-Prishtinë-Durrës do të sillte përveçse forcim të mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh Shqipëri-Serbi, edhe pagëzimin e Rrugës së Kombit me një emër të ri tejet kuptimplotë, siç është "Autostrada e paqes", që do t'i jepte mundësinë Serbisë për një dalje tjetër në Adriatik, siç është Porti i Durrësit.

(Koha DITORE, 27 nëntor)

Valentin Inzko, përfaqësuesi i lartë ndërkombëtar në Bosnje-Hercegovinë, thotë se secesioni i Republikës Srpska nuk do të lejohet. "Bashkësia ndërkombëtare i ka në duar të gjitha instrumentet për të vepruar. Ne kemi mandatin e Kombeve të Bashkuara dhe nuk do të lejojmë secesionin", deklaroi Inzko, në një intervistë ekskluzive me Deutsche Welle.

(Deutsche Welle, 27 nëntor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

Historia e Gjakovës

Burimet dëshmojnë se Gjakova ka qenë e banuar nga ilirë dardanë. Deri më 1582 ka qenë një vendbanim i vogël. Më 1662, në kronikat e udhëpërshkruesve të huaj përmendet si një qytet me 2000 shtëpi dhe 300 dyqane, ndërsa gjatë Rilindjes Kombëtare ishte qendër e rëndësishme e tregut të brendshëm shqiptar me rreth 1000 dyqane. Në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit u shquan figura të kësaj treve, si Sulejman Vokshi, Mic Sokoli etj. Edhe pas shtypjes së Lidhjes qyteti dhe malësia përreth mbetën vatra të kryengritjeve antiosmane. Në vitet 1912-1913, pas pushtimit të Kosovës e viseve të tjera nga ushtritë serbo-malazeze dhe pas vendimeve arbitrare në Konferencën e Londrës, Gjakova u shkëput nga trungu amtari.



ASH mbetet në pozicionin që të mbajnë Shëndetësinë dhe nëse jo - kjo parti kërkon nga LSDM të lëshojë Ministrinë e Arsimit, atë të Punës dhe Politikës Sociale, apo edhe të Transportit plus një ministër pa resor, kjo për të kompensuar uljen e pozicionit politik në Qeveri. Nga BDI janë të sigurt se Shëndetësia do t'i merret ASH-së dhe pak rëndësi do të ketë nëse atë do ta merr kjo parti apo LSDM

SHËNDETËSIA, NYJA E PAZGJIDHUR E PARTNERËVE QEVERTAR

"LUFTË" PËR POZICIONE TË FORTA



Në opinion flitet se nënkryetarja e LSDM-së, Renata Deskovska, mund të lëshojë dikasterin e Arsimit me qëllim të udhëheq me dikasterin e Drejtësisë, lëmi ku ajo ka një kualifikim të lartë akademik. Në këtë kombinorik, BDI mund të marrë shëndetësinë, ndërkaq ASH Ministrinë e Arsimit, që llogaritet më e dëshiruara nga partia e Selës

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 27 nëntor - Këto ditë, me interes po pritet plotësimi vendeve vakante në Qeveri, pa mos përjashtuar as opsionin e lëvizjes së më shumë ministrive mes partnerëve të koalicionit. Deri më tani, në prapaskenë është zhvilluar një luftë mes BDI-së dhe ASH-së, ku e para ende vazhdon të këmbëngul që resori i shëndetësisë të merret partisë së Ziadin Sela, e që për këtë të fundit do të ishte ulje e pozicionit politik në Qeverinë aktuale. Nga ana tjetër, ASH si kundërpërgjigje ndaj BDI-së, në takimin e fundit që ka pasur Sela me kryeministrin Zoran Zaev, i ka nxjerrë në tavolinë kërkesat që ASH të marrë njërin nga tre ministrinë e rëndësishme: dikasterin e arsimit, atë të transportit apo politikën sociale, plus një zëvendëskryeministër që mbulon një fushë të caktuar ose ministër pa resor. Burime zyrtare në ASH thonë se tashmë është vendosur, por ende nuk është zyrtare se pavarësisht cilën ministri do ta kenë, emri do të vijë nga

Dega e Tetovës, kjo për arsye se Tetova si qytet më i madh ku frekuentojnë shqiptarët dhe ku ASH tenton përfundimisht të marrë elektorin e PDSH-së që ka pasur ndër vite. "Fitorja në tre komuna dhe votat në zgjedhjet lokale në rrethin e parë që nxorën ASH-në në vend të dytë në të gjithë vendin ka bërë që jo vetëm Zaevi dhe një pjesë e mirë e strukturave të larta të LSDM-së, por edhe e ambasadorëve të vendeve më të rëndësishme evropiane ta shohin ASH-në si lojtarë kyç në ecurinë reformatore të qeverisë, e jo dikë tjetër si PDSH që ka zvogëluar votat në zgjedhjet lokale dhe nuk ka më peshë politike në elektoratin shqiptar", thonë për gazetë KOHA zyrtar partiak të ASH-së që duan të mbeten anonim. Sipas tyre, deri në moment të fundit, ASH do të këmbëngulë të mbajë Ministrinë e Shëndetësisë, më tej do të mbetet çfarë do të vendosin liderët partiak. "Mbetemi në pozicionin që ne të administrojmë me Shëndetësinë, përveç nëse Zaevi e Sela do të vendosin ndryshe, natyrisht në

të mirë të agjendës reformatore të Qeverisë", thonë zyrtarë të ASH-së. Nga ana tjetër, zyrtarë partiak nga BDI janë të sigurt se Shëndetësia do t'i merret ASH-së, por që ende nuk është vendosur nëse atë do ta merr BDI apo LSDM, por që kjo për zyrtarët BDI-së nuk do jetë shumë më rëndësi. "E sigurt është që Shëndetësia do të merret ASH-së, pastaj se kush do të jetë ministër dhe nga cila parti do të jetë - nga BDI apo LSDM, kjo ka pak rëndësi", thonë zyrtarë partiak të BDI-së. Në lidhje me emrin për zëvendësmministër të arsimit nga BDI dhe ministrit pa resor për investime të huaja, në partinë e Ali Ahmetit thonë se ende nuk është vendosur, por që me gjasë - emrat do të vijnë nga Dega e Çairit dhe ajo e Strugës. Zyrtarë të BDI përjashtojnë zërat se mund të ketë rikonstruim të Qeverisë përmes së cilit partnerët e koalicionit do të ndërrojnë të paktën tre dikastere. Ndryshe, në opinion ka zëra se mund të ketë ndërime ministrash në Shëndetësi, Pushtet Lokal, Arsim dhe Drejtësi. Në opinion flitet se nënkryetarja

e LSDM-së, Renata Deskovska, mund të lëshojë dikasterin e Arsimit me qëllim të udhëheq me dikasterin e Drejtësisë, lëmi ku ajo ka një kualifikim të lartë akademik. Në këtë kombinorik, BDI mund të marrë shëndetësinë, ndërkaq ASH Ministrinë e Arsimit, që llogaritet më e dëshiruara nga partia e Selës. Ndryshe, kryeministri Zoran Zaev të dielën paralajmëroi se deri në fund të këtij muaji do të plotësohen vendet vakante në Qeveri, këtë ai e tha në një mbledhje të Këshillit Drejtues të partisë së tij. Kur jemi tek përkrahja e shumicës parlamentare, Qeverinë e Zaevit e mbështesin edhe dy parti shqiptare - Lëvizja BESA me pesë deputetët e saj dhe PDSH me dy deputetë dhe një deputet që ka dal si i pavarur nga Koalicioni me VMRO-në. Përveç realizimit të reformave në disa sektorë të rëndësishëm, si në gjyqësor, media, shërbimin inteligjent dhe në administratën publike, për Qeverinë do të jetë sfida më e madhe hyrja në bisedime direkte me Greqinë për ndryshimin emrit

të shtetit. Që të ndodhin këto me sukses, shumicës parlamentare i duhet konsensus i brendshëm politik me partinë më të madhe opozitare VMRO-DPMNE, pa deputetët e së cilës disa ligje që prekin reformat e dëshiruara nuk mund të miratohen në Parlament. Megjithatë, kur jemi tek shumica parlamentare dhe partitë që e mbështesin atë, Ligji për gjuhët do të jetë çështja kyçe pa zgjidhjen e suksesshme të së cilës nuk mund të pritet edhe partneriteti i qëndrueshëm qeveritar. Tentimet e fundit të LSDM-së që me amendamente shtesë të ndryshojë karakterin e Ligjit për gjuhët, jo vetëm nga BDI dhe ASH, por aspak nuk është pritur mirë edhe nga Lëvizja BESA, e cila i ka ofruar përkrahje Qeverisë në kryerjen e reformave.

PETERLE PËR RTVM-në

Liderët të ndajnë ambicie të njëjtë evropiane

Shkup, 27 nëntor - Eurodeputeti sloven dhe kryetar i delegacionit të PE-së për Maqedoni, Alojz Peterle në bisedë për RTVM foli për gjendjen aktuale në Maqedoni, me porosi drejtuar liderëve politik të Maqedonisë të ndajnë ambicie të njëjtë evropiane dhe se dëshiron që politika e Maqedonisë të demonstrojë unitet për rrugën e Maqedonisë drejt BE-së. Eurodeputeti sloven dhe bashkëkryesues i Komitetit të përzier parlamentar Maqedoni-BE, që duhet së shpejti të mbajë takim, thotë se shpreson se do të përmbushen të gjitha kushtet për mbajtjen e tij. Lidhur me gjendjen politike në vend, Peterle thotë se ka stabilizim të dukshëm të të njëjtës, por vështirë është të thuhet nëse Maqedonia ka dalë tërësisht nga kriza. "Shumë gjëra u

ndryshuan, shpresa është se Maqedonia do të nisë përpara dhe se problemet e hapura do të fillojnë të zgjidhen", thotë Peterle. Në pyetjen nëse e tërë kjo do të kontribuojë që Maqedonia të nisë më shpejt në proceset e eurointegrimeve, Peterle vlerëson se kjo varet nga vetë shteti, me çfarë dinamike do të përparojë. Sipas studimit universitar të profesorëve nga universiteti Sen Galen në Zvicër dhe në Eseks të Anglisë, parashihet që Maqedonia të jetë vendi i vetëm kandidat i gatshëm për anëtarësim në BE rreth vitit 2023, pa u marrë parasysh me atë rast çështjet politike, siç është çështja e emrit. "Maqedonia para dhjetë viteve ishte vendi-kandidat i përgatitur më së miri. Nuk dua të flas shumë për data, madje edhe kur

flitej për Slloveninë, unë çdoherë thosha - kur do të jetë e gatshme Sllovenia, duhet të jetë e gatshme edhe BE-ja. Ia dëshiroj këtë edhe Maqedonisë. Në atë kuptim Maqedonia garon me veten e saj, ndërkaq sa i përket çështjes së emrit nga disa politikanë dhe profesionistë të ndryshëm, dëgjova sinjale të cilat e përforcojnë optimizmin se atmosfera do të përmirësohet dhe se gjërat do të marrin kahje tjetër. Do të thotë nuk jam i vetmi që shpreson se pas hapave të parë megjithatë do të vihet deri te zgjidhja që do ta ndihmojë Maqedoninë", tha ai. Për idenë për takim të partive politike të Maqedonisë me përfaqësues të Parlamentit Evropian dhe BE-së në afërsi të Parisit, në shtëpinë e Zhan Monesë, eurodeputeti sloven

theksoi se kjo është mundësi që politikanët të afrohen dhe të takohen me praktikën dhe me idetë nga vetë fillimi i Unionit. Për porosinë të cilën do të donte t'ia dërgojë miqve të tij dhe partive politike si dhe liderëve të tyre në Maqedoni, Peterle thotë se ajo është njëjtë si edhe më parë. "Porosia ime, do të thosha, çdoherë është e njëjtë - është mirë që të gjitha forcat politike në Maqedoni të ndajnë ambicie të njëjtë evropiane. Më kujtohet si ishte në Slloveni dhe në disa vende të tjera, çështja për BE-në neve nuk na ndau, kishim

koordinim i cili funksionoi mirë, në të merreshim me të gjitha çështjet më të rëndësishme dhe kjo ishte mirë. Do të doja që politika e Maqedonisë të demonstrojë unitet në rrugën e Maqedonisë drejt BE-së", tha Peterle. Fillimisht takimi i komitetit të përzier parlamentar Maqedoni-BE, ishte paraparë gjatë sesionit të dhjetorit në Strasburg, por me qëllim që ai të përgatitet më mirë, tani për tani nuk është konstatuar datë e re, por pritet që të mbahet sa më parë.



Vërejtjet kryesore të deputetëve VMRO-së, përmes amendamenteve të dorëzuara, janë se buxheti aspak nuk është zhvillimor dhe as reformues

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 27 nëntor - Përveç praktikës tani më të njohur nga partia opozitare VMRO-DPMNE me kërkesë të pauzës njëorëshe, debatin për buxhetin e vitit 2018, i cili të hënën e filloi Komisioni për financim dhe buxhet, deputetët e opozitës, me dorëzimin 204 amendamenteve, planifikojnë ta stërzgjinë debatin si në komisionin amë, po ashtu edhe në seancën plenare të Parlamentit, e cila parashihet të të futet në debat më 11 dhjetor. Vërejtjet kryesore të deputetëve VMRO-së, përmes amendamenteve të dorëzuara, janë se buxheti aspak nuk është zhvillimor dhe as reformues. Sipas opozitës, se vetë faktin se është buxheti më i lartë deri më tani nga pavarësia e Maqedonisë dhe se që të realizohet buxheti sipas projekteve makroekonomike, kjo qeveri do të duhet të rrisë tatimet si dhe të futet në borxhe te reja.

Liljana Kuzmanovska, deputete e VMRO-DPMNE-së, kërkoj nga ministri i Financave, Tevdovski, të jep sqarime se paratë nga rritja prej 4.1 për qind me shumë se buxheti i vitit të kaluar, për çfarë do të harxhohen. "Buxheti i këtij viti është më i lartë për 4.1 për qind nga buxheti i vitit të kaluar. Mirëpo, askund në buxhet nuk thuhet se për çfarë do të harxhohen këto para. Kjo lë përshtypje se keni projektuar buxhet me shifra të fryra dhe që të mund të realizohen buxheti i viti të ardhshëm, kështu siç e keni projektuar, do të jetë i mundshëm vetëm nëse rrisni tatimet apo nëse futeni në borxhe te reja. Të gjitha projektet infrastrukturore si pjesë e investimeve kapitale që janë paraparë me buxhet, janë të njëjtat ato projekte që janë filluar nga qeveria e mëparshme, të cilat, një pjesë e tyre, janë ndërtuar me para të kredive dhe vazhdojnë të ndërtohen po me paratë e parapara me buxhetin e viti të kaluar", tha Kuzmanovska.

FILLOI DEBATI PËR PROJEKT-BUXHETIN PËR VITIN 2018



279 AMENDAMENTE PËR BUXHETIN

I menjëhershëm ishte reagimi i deputetit të pozitës nga radhët LSDM-ës, Vasko Kovačevski, i cili Projekt buxhetin për vitin 2018 e cilësoi si buxhet zhvillimor, transparent, i cili kryesisht do jetë në shërbim të qytetarëve për një jetë më të mirë. "Pikërisht ky buxhet quhet edhe buxhet i qytetarëve, sepse me këtë buxhet më shumë para parashihen për qytetarët dhe kompanitë vendore, me qëllim që të kemi zhvillim më të mirë ekonomik, të rritet standardi jetësor i qytetarëve si dhe më shumë para për shëndetin e tyre", tha Kuzmanovski.

Lëvizja BESA, si parti opozitare shqiptare, ka dorëzuar 75 amendamente, përmes të cilave kjo lëvizje kërkon më shumë mjete për projekte që kryesisht kanë të bëjnë me vendbanimet me popullsi shqiptare dhe më këtë, sipas deputetëve të Lëvizjes BESA, do të sigurohet zhvillimi i barabartë për të gjithë tatimpaguesit që kontribuojnë në mbushjen e buxhetit. Ndryshe, gjatë ekspozesës së Projekt buxhetit për vitin 2018, ministri i Financave, Dragan Tevdovski, u shpreh se Propozim-buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitin 2018, është refleksioni më i mirë i angazhimit të Qeverisë së re për arritje të qëllimeve dhe prioriteteve

kyçe të shoqërisë, shkallë më të larta të rritjes së ekonomisë, rritje të punësimeve, ngritje të standardit jetësor të popullatës, arritje e nivelit më të lartë të drejtësisë sociale dhe intensifikim të proceseve integruese për në BE dhe në NATO.

"Propozim-buxheti e tregon përcaktimin e fuqishëm të Qeverisë për shpenzim efikas, ekonomik, transparent dhe shoqëror-të dobishëm të parave shtetërore. Mund të shihet qartë nga propozimi, paratë popullore do të shpenzohen për qëllime të vërteta, të cilat do të kontribuojnë për përmirësimin e ekonomisë dhe jetës së qytetarëve, e jo në projekte të panevojshme", theksoi Tevdovski.

Tevdovski gjithashtu potencoi se me Propozim-buxhetin për vitin 2018, janë paraparë disa mjete për shtyllat kyçe të shoqërisë si rroga më të larta në armatë, shëndetësi, arsim dhe kujdes për fëmijët. "Ka shumë mjete për afirim drejt standardeve të NATO-s, për mbështetje të ndërmarrjeve vendore dhe për masa për punësim, si dhe për investime kapitale. Gjithashtu me buxhetin e vitit të ardhshëm parashihen para për kthim të borxheve të marra paraprakisht dhe të obligimeve të hasura të papaguara", tha Tevdovski. Sipas ministrit të Financave,

Tevdovski, me Propozim buxhetin për vitin 2018, të ardhurat e përgjithshme planifikohen në nivel prej 193.512 milionë denarë, ndërsa shpenzimet planifikohen në nivel prej 211.745 milionë denarë, gjegjësisht 3,4 miliardë euro. Kështu, të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara rezultojnë me uljen e deficitit buxhetor në nivel prej 2,7 për qind nga BPV-ja ose 18.233 milionë denarë në vlerë absolute. "Deficit buxhetor do të financohet nga borxhi vendor dhe i jashtëm dhe me qëllim që borxhi të jetë i ulët, rritet akciza e naftës për tre denarë nga 1 janari i vitit 2018. Të ardhurat e përgjithshme për vitin e ardhshëm janë më të mëdha për 4.7 për qind në raport me këtë vit, ndërsa të ardhurat për 4.1 për qind. Me buxhetin e propozuar parashikohen investime kapitale, për pagesë në kohë dhe pa pengesa të rrogave, pensione, transfertave sociale, mbështetjes së kompanive vendore", tha ministri i Financave Tevdovski. Debatin për propozim buxhetin në Komisionin për financim dhe buxhet do të zgjasë 10 dite ku do të shqyrtohen 279 amendamente të dorëzuara nga partia opozitare, VMRO-DPMNE dhe partia opozitare shqiptare, Lëvizja BESA.

BE dëshiron të shohë përkushtim për reforma

Kumanovë, 27 nëntor - Procesi i reformave në Maqedoni vazhdon. Atë që ne si Bashkimi Evropian duam ta shohim është të ekzistojë përkushtim jo vetëm nga ana e Qeverisë për vazhdim të reformave, por edhe nga Kuvendi dhe nga partitë politike, porosit të hënën në Kumanovë euroambasadori Samuel Zbogor në takim me kryetarin e Komunitetit Maksim Dimitrievski. "BE-ja e mirëpret vazhdimin e procesit të reformave. Kuptohet që duhet nga vetë institucionet shtetërore të ketë dërgim të rezultateve, dhe nëse institucionet duhet të vazhdojnë me dërgimin e këtyre rezultateve, kuptohet se nëse kjo do të ketë efekt pozitiv ndaj vetë marrëdhënieve midis BE-së për vendit vitin e ardhshëm", deklaroi Zbogor. Ai shtoi se që të realizohen reformat nevojitet të ketë bashkëpunim midis të gjithë faktorëve politik dhe se kjo është me rëndësi të madhe. "Në këtë kontekst shohim bashkëpunim midis Qeverisë dhe opozitës, gjegjësisht partive në Kuvend dhe ne si Bashkim Evropian e inkurajojmë këtë proces dhe shpresojmë se ky lloj i bashkëpunimit midis partive politike në Kuvend do të vazhdojë në të ardhmen dhe do të japë rezultate", tha Zbogor. Ai theksoi se në pajtueshmëri të planit të Qeverisë 3-6-9, disa ligje tanimë janë miratuar në Kuvend, ndërsa gjithashtu ekziston plan i qartë se si institucionet të ballafaqohen me materialet e përgjuara dhe vetë pajisjen e cila tanimë ekziston në kuadër të DSK-së, ndërsa ekziston plan edhe për publikim të shpalljes publike për përbushje të vendeve të punës në vetë institucionet e pavarura. Në takim me Dimitrievskin, Zbogor është informuar me implementimin e projekteve vijuese infrastrukturore në Kumanovë, midis tyre për rikonstrukcion të rrjetit të kanalizimit.

"Monstra" i dorëzohet Apelit

Shkup, 27 nëntor - Rasti "Monstra" tani gjendet në Gjykatën e Apelit dhe gjatë ditës së djeshme ose më së voni deri sot, në orët e para të mëngjesit, do të transferohet në Gjykatën Themelore të Shkupit. Prej aty do të dalë vendimi për lirim ose jo nga paraburgimi të të dënuarve për vrasjen e pesëfishtë në afërsi të Liqenit të Smillkovës. Nga Gjykata Supreme për TV Shenja konfirmuan se lënda është dërguar në Apel që në mëngjes, ndërsa Apeli na siguroi se në momentin që lënda do të jetë

përgatitur dhe dërguar në Gjykatën Penale, do jemi të informuar me kohë. "Ne po e përgatisim lëndën. E kemi marrë prej Gjykatës Supreme. Besoj se sot gjatë ditës ose më së voni deri nesër (e martë) në mëngjes do ta dërgojmë në Gjykatën Penale", ka thënë për TV Shenja, Safet Kadriu, zëdhënës i Gjykatës së Apelit. Dy ditë më parë, Gjykata Supreme vlerësoi që rasti "Monstra" meriton rigjykim duke u bazuar në kërkesën e prokurores, Liljana Spasovska dhe të avokatëve

mbrojtës që në seancat e hapura të Gjykatës Supreme, shprehën zhgënjimin nga një vendim gjyqësor në ajër. Tani çështja është nëse Këshilli i Gjykatës Penale do të vendosë që të dënuarit të lirohen nga paraburgimi dhe të mbrohen në liri në një proces të përsëritur gjyqësor, pasi edhe ashtu qëmoti kanë përbushur dy vjet paraburgim, që është maksimumi i lejuar me Ligjin për Procedurë Penale. Këshilli Penal pasi të marrë dhe të shqyrtojë lëndën, ka 48 orë për të sjellë ven-

dim pro ose kundër liritimit nga paraburgimi. Për rastin "Monstra", gjashtë shqiptarë janë dënuar me burg të përjetshëm, tre prej tyre janë në burg që nga 1 maji i vitit 2012, njëri është në burg që nga viti 2013, ndërsa dy të tjerë gjenden në arrati. Ata u dënuan për vrasjen e pesë të rinjve maqedonas në afërsi të Liqenit të Smillkovës që është kualifikuar si vepër terroriste, një prej veprave më të rënda në Kodin Penal dhe për këtë po vuajnë dënimin me burg të përjetshëm. (tv shenja)

SHTOHEN TRANSFERIMET PËR TE UNIVERSITETET EVROPIANE

**IKIN EDHE PA
PËRFUNDUAR
STUDIMET**

Nuk janë vetëm kategoria e të diplomuarve që synojnë një jetë më të mirë në shtetet e BE-së, por është një numër i madh i studentëve që largohen nga Maqedonia duke shfrytëzuar ECTS-në (Sistemin Evropian të Transferimit të Kredive)



Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 27 nëntor - Trendi i largimit të të rinjve nga Maqedoni për në shtetet e zhvilluara evropiane, sidomos të Bashkimit Evropian po josh çdo herë e më tepër kuadrot me arsim të lartë. Ky fenomen i diskutuar prej vitesh dhe i konfirmuar nga institucione kompetente, nuk kalon pa lënë gjurmë edhe brenda vetë institucioneve të arsimit të lartë. Janë pikërisht universitetet që ndjejnë "ikjen e turit", edhe atë që kur është në proces të krijimit, respektivisht kur të rinjtë janë në vijim të studimeve. Viteve të fundit rritet numri i atyre që ndërprejnë studimet në Maqedoni për t'i vijuar të njëjtat në shtete evropiane, me qëllim të qasjes më të lehtë dhe të integritetit më të shpejtë në shoqëritë e shteteve mikpritëse. Pra, nuk presin të përfundojnë studimet dhe në mungesë të vendit të punës të kërkojnë një treg të ri, i cili ofrohet me shumë perspektivë në vendet e BE-së, por ikin pa i përfunduar studimet.

Nuk janë vetëm kategoria e të diplomuarve që synojnë një jetë më të mirë në shtetet e BE-së, por është një numër i madh i studentëve që largohen nga këtu. Duke shfrytëzuar mundësinë e lëvizjes së lirë të studimeve në hapësirën evropiane, apo detyrimin e universiteteve për të funksionuar me ECTS-në (Sistemin Evropian të Transferimit të Kredive), studentët nga Maqedonia gjejnë një rrugë më të lehtë për të shkuar në Evropë. Në Zyrën për çështje arsimore të Universitetit të Tetovës, ku përpunohen të dhënat dhe analizat për transferimet e studentëve, pohojnë se një vend dominues zë kategoria e atyre që kërkojnë transferime për në shtete si Gjermania, Zvicra, Austria e kështu me radhë.

"Për fatin jo të mirë të vendit, kemi shumë

raste kur studentët tanë çregjistrohen nga këtu dhe vazhdojnë studimet në botën e jashtme, sidomos në Gjermani, Zvicër dhe shtete të ngjashme", pohon Ibrahim Neziri, përgjegjës në zyrën e çështjeve arsimore në UT. Ai thotë se institucionet e arsimit të lartë, ashtu si UT-ja, kanë informacione për numrin e studentëve që transferohen në universitetet e shteteve evropiane, sepse "vazhdimisht i përgatisim dokumentet e çregjistrimit të studentëve, me kërkesë të këtyre të fundit, që përmes transferimit të kredive të regjistrohen në universitete e shteteve evropiane", sikurse shprehet ai. Në tre-katër vitet e fundit, sipas Nezirit, transferimet e studentëve nga UT-ja në ndonjë universitet evropian dominohen nga ata që janë në fakultete e shkencave mjekësore.

"Ajo që mund të theksohet për transferimin e studentëve gjatë tre-katër viteve të fundit është se shumë studentë të cilët vijojnë mjekësinë këtu, në vitin e tretë, të katërt ose të pestë transferohen në universitetet e shteteve evropiane", pohon Neziri, duke nënvizuar se transferimet për jashtë nuk kufizohen vetëm me studentët e mjekësisë por se gama e tyre është zgjeruar edhe me kuadro të fakultetit të ekonomisë, shkencave natyre dhe teknike.

Maqedonia është në top 10 vendet e Evropës Juglindore me shkallën më të lartë të shpërnguljes së popullsisë. Statistikat e Euro-

statit tregojnë se në 15 vitet e fundit kanë ikur 10 për qind e popullsisë, ndërsa anketat e realizuara me studentë flasin se rreth 29 për qind e tyre tashmë gjenden jashtë kufijve të Maqedonisë. Një përqindje shumë e lartë e të anketuarve, rreth 70 për qind deklarohen se dëshirojnë të largohen pas përfundimit të arsimit. Sipas sociologëve, arsyeja kryesore për "ikjen e trurit" është mungesa e perspektivës në Maqedoni. Sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara, nga viti 1990 vendin e kanë lëshuar 14 për qind e banorëve, por në vitin 2010 ky numër u ngjiti mbi 20 për qind. Trendi i rritjes mbështete edhe nga të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikave. Nëse në vitin 2008 nga Maqedonia janë larguar 740 persona, në vitin 2012 ky numër ishte 1.340 persona. Të dhënat për largimin e personave të kualifikuar janë shqetësuese, aq më tepër kur. Maqedoninë nuk e

braktisin vetëm mjekët dhe informatikanët, si deri para pesë-gjashtë viteve, por edhe ekonomistë, juristë apo hulumtues shkencor. Pjesa më e madhe e tyre do të kishin shkuar pa asnjë problem në vendet e BE-së, kurse opsionet tjera të kapshme janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Australia. Kështu, vendin do ta braktisnin rreth 70 për qind e studentëve të anketuarve nëse do t'u ofrohej punë në ndonjë shtet të jashtëm, kurse 20 për qind e tyre kanë ndërmarrë aktivitete konkrete për ta lëshuar Maqedoninë.

"Për fatin jo të mirë të vendit, kemi shumë raste kur studentët tanë çregjistrohen nga këtu dhe vazhdojnë studimet në botën e jashtme, sidomos në Gjermani, Zvicër dhe shtete të ngjashme", pohon Ibrahim Neziri, përgjegjës në zyrën e çështjeve arsimore në UT

statit tregojnë se në 15 vitet e fundit kanë ikur 10 për qind e popullsisë, ndërsa anketat e realizuara me studentë flasin se rreth 29 për qind e tyre tashmë gjenden jashtë kufijve të Maqedonisë. Një përqindje shumë e lartë e të anketuarve, rreth 70 për qind deklarohen se dëshirojnë të largohen pas përfundimit të arsimit. Sipas sociologëve, arsyeja kryesore për "ikjen e trurit" është mungesa e perspektivës në Maqedoni. Sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara, nga viti 1990 vendin e kanë lëshuar 14 për qind e banorëve, por në vitin 2010 ky numër u ngjiti mbi 20 për qind. Trendi i rritjes mbështete edhe nga të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikave. Nëse në vitin 2008 nga Maqedonia janë larguar 740 persona, në vitin 2012 ky numër ishte 1.340 persona. Të dhënat për largimin e personave të kualifikuar janë shqetësuese, aq më tepër kur. Maqedoninë nuk e



Vazhdojnë hetimet e vrasjes së Ismetit

Shkup, 27 nëntor - Prokuror publik nga Prokuroria e Shkupit i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme për zbulimin e autorit dhe motivit për vrasjen që ndodhi të premten në mbremje në lagjen Çair të Shkupit, ku i vranë në vendngjarje mbeti Ismet Arifi (35) nga fshati Bllacë, ndërsa Qemal Lusjani (52) nga Shkupi mbeti i plagosur rëndë. "Janë siguruar video regjistrimet nga kamerat që ndodhen në rrethinë në vendin ku ka ndodhur vrasja dhe të njëjtit do të jenë lëndë e analizës. Me urdhër të prokurorit publik trupi i të ndjerit është dorëzuar për autopsi. Në të njëjtën kohë, janë lëshuar shumë urdhra për ekspertizë të gëzhgojave, të veshjes, të gjurmëve të gjakut dhe të sendeve të tjera të gjetura dhe marra nga vendi i ngjarjes", qëndron në kumtesën e Prokurorisë.

Mbyllen tetë bastore në Shkup dhe Tetovë

Shkup, 27 nëntor - MPB dhe DAP-i mbyllën dhe plumbuan shtatë bastore sportive në Shkup dhe Tetovë, ndërkaq do të parashtrihen edhe padi penale ndaj disa personave. Siç kumtoi MPB, pas njohurive të marra paraprakisht, Ministria në bashkëpunim me Drejtorinë për të Ardhura Publike, realizoi kontroll aksioni në tetë bastore sportive, dy në Shkup dhe gjashtë në Tetovë. Nga kontrollet e kryera në tetë objektet, vetëm njëri prej tyre ka poseduar licencë për punë në fshatin Bogovinë-rajoni i Tetovës. Në shtatë të tjerat, nga policia është konstatuar se ato kanë punuar në mënyrë të parregullt, për ç'arsye nga ana e DAP-it janë dhënë Vendime për ndalesë për organizim të lojërave të fatit në hapësirë afariste në afat prej 30 ditëve, sipas nenin 151 paragrafi 6 nga Ligji për lojërat e fatit dhe për lojërat argëtuese. Nga objektet, policia ka marrë 70.500 denarë, 305 euro, 100 franka zvicerane, etiketa për pagesë, si dhe pajisje prej 39 televizorëve, 21 kasa e kompjuteri, 19 monitorë kompjuteri, 11 printerë për etiketa, tre resiverë televizioni, tre printerë dhe lexues të barkodeve, dy aparate për gara të qenve dhe të tjera. Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë kryer edhe dy bastisje në një shtëpi dhe një banesë. Janë zbuluar dhe konfiskuar pajisje kompjuterike, printerë për etiketa, formularë të zbrazët të ndeshjeve sportive, evidencë me shkrim të personave të cilët kanë paguar ndeshje sportive, bartës të të dhënave elektronike.

Damçevski shpallet fajtor, gënjeu pacienten se ishte shtatzënë

Shkup, 27 nëntor - Mjeku Nikollçe Damçevski, specialist për gjinekologji dhe obstetrikë, është fajtor për rastin në të cilin ka trajtuar si shtatzënë një grua deri në kohën e lindjes, kur i kumtoi se nuk është shtatzënë, konfirmoi Këshilli i Shkallës së dytë pranë Gjykatës së nderit të Odës së Mjekëve të Maqedonisë. Në seancën e mbajtur më 23 të këtij muaji, Këshilli i shkallës së dytë e ka konfirmuar vendimin e miratuar nga Këshilli gjyqësori i shkallës së parë. "Me të, dr. Nikollçe Damçevski është shpallur fajtor në procedurën për

rastin kur ka mjekuar dhe ka zbatuar procedurë të fertilizimit të ndihmuar biologjik të pacientes, e ka evidentuar si shtatzënë, edhe pse ajo nuk ka qenë. Në tërë këtë periudhë të të ashtuquajturës shtatzëni, mjeku e ka përcjellë, e ka informuar për përparimin e shtatzënisë, ka dhënë terapi për mbajtjen e shtatzënisë deri në gjoja - kohën për lindje, kur edhe i kumtoi se as që nuk ekziston shtatzëni. Me veprimet e cekura, siç vlerësoi Gjykata e nderit, mjeku i ka shkelur dispozitat nga Kodeksi i deontologjisë mjekësore dhe iu sh-

qiptua masa e marrjes së përkohshme të licencës për punë në kohëzgjatje prej shtatë vitesh", thuhet në kumtesë.



MANTELBARDHËT DREJT EVROPËS

DO MBESIM PA MJEKË, PËR 5 VITE IKËN 900!

Gjermania është destinacioni të cilin mjekët nga Maqedonia e zgjedhin më shpesh për të punuar, por këtu është edhe Zvicra dhe vende tjera të Evropës. Gjatë 5 viteve të fundit rreth 900 mjekë kanë kërkuar dokumentet e tyre nga Oda e Mjekëve e Maqedonisë që të mund të angazhohen jashtë



Shkup, 27 nëntor - Mantelbardhët e Maqedonisë vazhdojnë të ikën. Kjo dukuri është shpesh sidomos vitet e fundit, ku si arsye është punësimi i tyre në shtetet dhe ku pagesa është më e mirë. Kështu, gjatë 5 viteve të fundit, rreth 900 mjekë kanë kërkuar dokumentet e tyre nga Oda e Mjekëve e Maqedonisë që të mund të angazhohen jashtë. Gjermania është destinacioni më i preferuar të cilin mjekët e zgjedhin më shpesh për të punuar, por këtu është edhe Zvicra dhe vende tjera të Evropës, (për Zvicër, hëpërhë nuk mund të jepet një shifër e saktë sa është ky numër i mjekëve që kanë braktisur këtë shtet).

Ish-ministri i Shëndetësisë, Arben Taravari, në një prononcim kohë më parë për Albinfo.ch, pati thënë se vetëm në dy vitet e fundit - numri i mjekëve të larguar nga Maqedonia për në shtetet e Evropës kalon numrin 200. Në shëndetin publik shpeshherë madje mungojnë infermiere. I fundit është shembulli në spitalin e përgjithshëm të qytetit "8 shtatori" në Shkup, ku për shkak të mungesës së instrumenteve teknike dhe infermiereve, përkohësisht janë mbyllur disa departamente dhe salla të operimit. Ky staf profesional ngadalë, por sigurt po humbet, ndërsa një nga arsyet kryesore është po ashtu punësimi në vende jashtë shtetit. Vlerësohet se së paku 400 infermiere kanë ndërruar uniformën nga shëndeti publik dhe kanë veshur ose uniformën e ndonjë spitali privat në Maqedoni, apo i janë bashkangjitur kolegëve në Kroaci, Gjermani apo Austri, disa dhe në SHBA dhe Australi.

VETËM SIVJET, 120 KËRKESA

Numri i mjekëve që janë larguar nga vendi për të punuar në shtete të tjera është vazhdimisht

KËRKESË E MADHE PËR KURSET E GJERMANISHTES

Rreth 1000 qytetarë nga Kosova vetëm gjatë këtij viti kanë ndjekur kursin intensiv të gjuhës gjermane në institutin "Gëte" në Prishtinë, shumica prej tyre mjekë dhe infermierë, të cilët kanë vendosur që të largohen nga vendi dhe të punësohen në Gjermani, ku vlerësojnë se kanë perspektivë më të madhe. Annamaria Farkas-Mecinaj, drejtoreshë e institutit "Gëte", ka bërë të ditur për mediat në Prishtinë se gjatë vitit 2016 kurset e tilla i kishin ndjekur rreth 1200 vetë, ku interesimi më i madh është nga gjeneratat e reja, kryesisht mjekë dhe infermierë, të cilët po kërkojnë mundësi punësimi në Gjermani.

në rritje. Sipas të dhënave të Odës së Mjekëve në Maqedoni - në vitin 2012, 138 mjekë kanë kërkuar vërtetim që të mund ta kryejnë punën e mjekut jashtë vendit, ndërsa në vitin 2016 këtë dokument e kanë kërkuar 172 mjekë. "Gjatë vitit 2017, deri në ditën e enjte - nga Oda e Mjekëve 120 mjekë kanë kërkuar një vërtetim me të cilin do të mund ta ushtrorin profesionin mjekësor edhe jashtë vendit", thonë nga Oda e Mjekëve të Maqedonisë. Kompetentët, madje alarmojnë nga pasoja e këtilla, ndërsa fajin hedhin

në politikat e gabuara që seriozisht po prekin sistemin shëndetësor. "Mjekët si profesion, janë të nënçmuar deri në atë masë që nuk duan të punojnë më këtu. Arsyet dihen, politikat shëndetësore të pushtetit të deritanishëm apo regjimi që solli në atë që një numër i madh i tyre të mos pajtohen të punojnë në Maqedoni. Kushtet të cilat po përjetojnë mjekët në Maqedoni nuk ekzistojnë as në Ballkan apo vend tjetër. Arsyet ekonomike janë me rëndësi, por jo edhe vendimtare", ka pohuar Dejan Sta-



DEJAN STAVRIQ

Mjekët si profesion, janë të nënçmuar deri në atë masë që nuk duan të punojnë më këtu. Arsyet dihen, politikat shëndetësore të pushtetit të deritanishëm apo regjimi që solli në atë që një numër i madh i tyre të mos pajtohen të punojnë në Maqedoni. Kushtet të cilat po përjetojnë mjekët në Maqedoni nuk ekzistojnë as në Ballkan apo vend tjetër. Arsyet ekonomike janë me rëndësi, por jo edhe vendimtare

vriq, ish lider i Sindikatës së mjekëve në Qendrën klinike në Shkup. Dëmi që pëson sistemi shëndetë-

sor, sipas Stavriq, është i madh, ndërsa çmimin do e paguajnë qytetarët.

ÇMIMIN DO E PAGUAJNË QYTETARËT

Për atë se pse ikin dhe si të mbahet ky personel në spitalet shtetërore, nga Shoqata e Infermiereve të Maqedonisë, thonë se ka disa arsye. "Shumë nga infermieret, të cilat kanë mbaruar shkollimin e mesëm profesional, përcaktohen për profesione të cilat paguhen më mirë dhe ku mund të ndërtojnë karrierë akademike. Pësia e punës dhe puna me ndërrime është gjithashtu një nga arsyet për mungesën e infermiereve tek ne, nëse merret parasysh fakti se shumica nga të punësuarit janë gra, të cilat kanë rol kyç në familjen. Me liberalizimin e vizave, shumë infermiere nga Maqedonia vendosën karrierën e tyre profesionale ta vazhdojnë në vendet e zhvilluara evropiane, ku gjithsesi motiv janë të ardhurat mujore, por dhe zhvillimi i karrierës dhe mundësia për përvetësim më të lartë të arsimit në magjistraturë apo doktor në infermiere", thonë nga Shoqata e Infermiereve të Maqedonisë. Mirëpo nuk është vetëm paga arsye për largimin e këtij stafi nga spitalet dhe klinikat, por dhe ngarkesa e punës. Në vendet e BE-së, norma mesatare është 8.4 infermiere në 1000 banorë, për dallim nga Maqedonia ku kjo mesatare është 4. Këto janë të dhënat nga publikimi i fundit "Health at a glance" e Këshillit të Evropës në vitin 2016. Në lidhje me raportin mjek-infermiere, norma mesatare në BE është 2.5 infermiere në 1 mjek, ndërsa në Maqedoni është 1.4 infermiere në 1 mjek, që tregon se infermieret janë kuadër deficitar në shëndetin publik, të mbingarkuar me punë. (albinfo.ch)

MJEKËT NGA KOSOVA DREJT ZVICRËS

Numri i mjekëve që po braktisin Kosovën për Zvicrën po rritet dita-ditës. Këtë e pranojnë edhe zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovë. Zëdhënësi i kësaj ministrie, Faik Hoti në një intervistë për albinfo.ch tregon shkaqet e kësaj dukurie. "Largimi i një numri profesionistësh shëndetësorë (mjekë dhe infermierë) nga vendet e tyre që është më shumë karakteristik për vendet e Lindjes, por së fundi edhe për vet vendet e Evropës ka prekur pothuajse edhe të gjitha vendet e Ballkanit, përfshirë këtu edhe Kosovën. Mjekët dhe infermierët nga Ballkani e kanë si qëllim kryesisht Gjermaninë e Zvicrën, sikurse edhe shumica e kolegëve të tyre të vendeve të Lindjes. Kjo, për shkakun që dihet, se kushtet profesionale në shtetet perëndimore krahasuar me vendet e Lindjes dhe të Ballkanit janë më shumë më të mira. Nga ana tjetër, vendet si Gjermania, Franca

dhe disa shtete të tjerë në perëndim kanë mungesë kuadri, sidomos të kuadrit infermieror, pasi që kuadri i këtyre shteteve, sipas të dhënave, po lëviz drejt shteteve skandinave. Në Kosovë, asnjë institucion nuk ka të dhëna të sakta se sa mjekë apo infermierë mund ta kenë lëshuar Kosovën në vitet e fundit, sepse askush që largohet nuk njofton për këtë shkuarje në ndonjë institucion që mban statistika të këtilla. MSh ka të dhëna vetëm për numrin e mjekëve të regjistruar e licencuar pas luftës në Kosovë dhe jo për ata që kanë ikur. Megjithatë, sipas një hulumtimi të kryer nga profesionistë shëndetësorë që kanë qenë pjesë e MSh-së, numri i profesionistëve shëndetësorë të larguar nga Kosova në Gjermani sipas viteve që kanë qenë pjesë e hulumtimit (2009-2013) është si vijon: 2009-10; 2010-26; 2011-67; 2012-67; 2013-109", ka thënë Hoti.

OPERATORËT TELEFONIK ME DETYRIME NDAJ ATO-së

DSK MË PAK KOMPETENCA

PËR PËRGGJIMET

Detyrimet ligjore, të cilat operatorët telefonik deri më sot duhej t'i plotësojnë komfor dispozitave që burojnë nga Ligji për Komunikime Elektronike, pas miratimit të Ligjit të ri për përcjelljen e komunikimeve, të njëjtat do të përfshihen në neni 60 të këtij ligji, i cili kryesisht parasheh raporte të ngushta mes operatorëve dhe Agjencisë tekniko-operative

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 27 nëntor - Shfuqizimi i nenit 175 të Ligjit për Komunikime Elektronike, ndonëse u paralajmërua se nuk do të ekzistoi më, sipas reformave që po bëhen në sistemin e sigurisë shtetërore, pritet të bëhet pjesë e Ligjit të ri për përcjelljen e komunikimeve. Ndryshimet e reja që po bëhen në drejtim të rregullimit të çështjes së përgjimeve dhe mbrojtjes nga keqpërdorimet, Qeveria e kryesuar nga kryeministri Zoran Zaev është duke realizuar në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian. Dispozita e nenit 175, e miratuar në vitin 2014, i obligonte operatorët telefonik që të sigurojnë të gjitha kushtet e nevojshme teknike përmes të cilëve - Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim do t'i përgjojë (përcjellë) komunikimet e realizuar nga rrjetet e tyre. Sektori civil, por edhe ai profesional, duke u thirrur në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, para Gjykatës Kushtetuese në korrik të këtij viti parashtrori një iniciativë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit në fjalë. Megjithatë, nga kjo gjykatë nuk arritën të miratojnë vendim përfundimtar. Ndërkohë, nga Qeveria - me vendim paraprak, kërkuan nga Gjykata Kushtetuese ndalimin e kësaj procedure, me arsyetim se ato janë duke punuar në drejtim të reformimit të sistemit të sigurisë në vend. Detyrimet ligjore, të cilat operatorët telefonik deri më sot duhej t'i plotësojnë

komfor dispozitave që burojnë nga Ligji për komunikime elektronike, pas miratimit të Ligjit të ri për përcjelljen e komunikimeve, të njëjtat do të përfshihen në neni 60 të këtij ligji, i cili kryesisht parasheh raporte të ngushta mes operatorëve dhe Agjencisë tekniko-operative (ATO). Me disa plotësime të vogla, ashtu siç ishin raportet me Drejtorinë për Siguri dhe Kundërzbulim, operatorët telefonik duhet t'i respektojnë edhe gjatë bashkëpunimit me zyrtarët e ATO-së. Në këtë drejtim, neni 60 i Ligjit për përcjellje të komunikimeve parasheh se detyra e operatorëve kundërshtojë agjencisë së re që duhet të themelohet, janë sigurimi i të gjitha kushteve për përcjelljen e komunikimeve në rrjetet e tyre. Tutje, përmbledhja prej nëntë paragrafëve thotë se operatorët, me harxhime të tyre duhet t'i sigurojnë dhe mirëmbajnë pajisjet, të vendosin komunikime elektronike për transfer të rrjetit deri te ATO, me të vetmin qëllim zbatimin e masave për përgjime të rrjeteve të tyre. Operatorët telefonik po ashtu në raport me ATO-n, do të jenë të obliguar t'i sigurojnë të gjitha pajisjet ndërmjetësuese të cilët do të reflektojnë në sinjalin e agjencisë. "Në rast se operatorët kanë të vendosur kriptu-mbrojtje ndaj një sinjali të komunikimit, atëherë ato janë të detyruar ta largojnë atë, para se të njëjtin ta

transferojnë në komunikimin e radhës deri te ATO. Mes tjerash, operatorët telefonik, të cilët për momentin në shtetin tonë janë vetëm dy, kanë për detyrë që Agjencisë tekniko-operative t'i sigurojnë përcjelljen e komunikimeve në kohë reale. Informacioni për komunikimin e përgjuar duhet të jetë në dispozicion menjëherë pas përfundimit të bisedës, ndërkohë që përcjellja e saj duhet të jetë e vazhdueshme përderisa ajo zgjat. Përmbajtja e komunikimit të përgjuar, nga operatorët duhet të sigurohet në kohë dhe e njëjta të korrespondojë me informacionin e përcjellë", thuhet në disa prej paragrafëve të nenit 60, të propozim-ligjit të ri për përcjellje të komunikimeve. Angazhim tjetër të cilin duhet ta respektojnë operatorët telefonik është kualiteti i përgjimeve, gjegjësisht dispozitat ligjore i obligojnë operatorët që të kujdesen që personat, të cilat përgjohen - mos të vërejnë asnjë lloj të ndryshimit të shërbimit komunikues e kështu me radhë. Ndryshe, siç u paralajmërua ditë më parë, pasi deputetët të votojnë për themelimin e Agjencisë tekniko-operative, ata po ashtu do ta zgjedhin edhe drejtorin e këtij institucioni të ri, i cili në të ardhmen duhet të kujdeset që sistemi i përcjelljes së komunikimeve mos të keqpërdoret, ashtu siç ishte rasti me periudhën vjetor 2008-2015.

ANULOHE SEANCA PËR RASTIN "TREQIND"

Në Gjykatën Penale të hënën sërisht u anulua seanca për lëndën e PSP-së, "Treqind", në të cilin është i akuzuar ish-ndihmës ministri i Punëve të Brendshme, Gjoko Popovski për keqpërdorim të detyrës zyrtare lidhur me furnizimin publik të 300 automjeteve. Popovski u paraqit në seancë, por siç tha avokati i tij, vetëm sepse ka qenë nën presion të opinionit. Avokati i tij kërkoi anulim të seancës sepse i akuzuari është mjekuar nga depresioni dhe për këtë arsye nuk ka qenë në gjendje që të marrë pjesë në gjykim. Gjykata për debatin e ardhshëm kryesor të caktuar për më 1 dhjetor e ftoi mjekun që i ka dhënë pushim mjekësor Popovskit të japë sqarim për gjendjen

shëndetësore, ndërsa në mënyrë shtesë me kërkesë të Prokurorisë do të thirret edhe psikiatri, i cili do të tregojë nëse i padituri do të mund ta përcjellë gjykimin. Popovski dyshohet se e ka dëmtuar buxhetin për 453.570 euro. Sipas PSP-së, Popovski ilegalisht ka ndarë marrëveshje për shit-blerje dhe mirëmbajtje të automjeteve të Morshe Maqedoni SHPKNJ Shkup, Ka-Dis SHPK Shkup, Bohemia Automobili Rous SHPKNJ Shkup, Kolevski SHPK Shkup dhe Avto Kuqa SHPK Shkup të zgjedhura si oferta më të volitshme ekonomike. Në këtë lëndë, Gjykata e Apelit vendosi se bisedat e përgjuara mund të përdoren si material dëshmues.

KRONIKË

Gjendet i vdekur në Kodrën e Diellit plaku nga Shkupi

Në Kodrën e Diellit të dielën mërzë është gjetur i vdekur një 74 vjeçar me iniciale S.P nga Shkupi. Sipas policisë, ai është gjetur i vdekur në lagjen e vikend shtëpizave. Me urdhër të gjykatësit hetues, ekipet e Sektorit për Punë të Brendshme, kanë kryer kontroll dhe nuk janë konstatuar shenja dhune. Po ashtu me urdhër të Prokurorit Publik do të kryhet obduksion në trupin e pajetë të 74 vjeçarit, i cili gjatë kohë ka jetuar vetë në vikend shtëpizë. Janë ndërmarrë masa për zbardhjen e plotë të rastit.

Aksione në disa lokale në Tetovë dhe Gostivar

Pjesëtarë të Policisë së Tetovës, të dielën mërzë deri pas mesnate kanë kryer aksion kontrolli në katër objekte hotelerike në Tetovë, në rrugën "Bllagoja Toska", Ivo Lolla Ribar dhe Boris Kidriç. Në këto objekte, janë legjitimuar 56 persona, prej të cilëve 5 nuk kanë pasur dokumentacion për identifikim, prandaj edhe janë arrestuar, si dhe janë ndaluar gjashtë të mitur. Në mesin e këtyre fëmijëve të vegjël njëri ka konsumuar alkool dhe është shërbyer me pije alkoolike, në kundërshtim me ligjin. Po ashtu në këtë drejtim janë konstatuar edhe dy shkelje të ligjit për pirje të duhanit. Të gjitha shkeljet do të sanksionohen me padi adekuate. Po ashtu në ndërkohë është realizuar edhe aksion në një lokal në Gostivar, ku janë legjitimuar 32 persona, prej të cilëve 5 të mitur të cilët kanë konsumuar alkool ndërsa janë regjistruar shkelje të ligjit për pirjen e duhanit si dhe janë inicuar edhe padi adekuate për prishje të rendit dhe të qetësisë publike.

Shkup, 22 aksidente për dy ditë

Nëntë persona janë lënduar më lehtë në pesë prej gjithsej 22 aksidentëve rrugore gjatë tre ditëve të fundit në rajonin e SPB Shkup. Në 17-të aksidente është shkaktuar dëm material, informojnë nga Ministria e Punëve të Brendshme. Polica rrugore këtë fundjavë ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh të kundërvajtjeve. Njëqind shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, katër kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe, pesë shoferë nuk kanë dhënë përparësi kalimi dhe 28 persona të cilët kanë drejtuar automjetet të paregjistruar. Nga komunikacioni janë përjashtuar 38 persona, 14 shoferë të cilët e kanë drejtuar automjetin në ndikimin e alkoolit, 21 persona para se të fitojnë të drejtën për të drejtuar automjetet dhe tre shoferë fillestarë. Janë sanksionuar edhe pesë këmbësorë të cilët kanë kaluar jashtë vijave të bardha për këmbësorë. Janë kapur 81 automjete të parkuara në mënyrë të papërshtatshme. Me ndihmën e automjetit special karro-trec janë larguar 178 automjete.

Vidhen 130 mijë denarë nga një kazino në Shkup

Një kazino në bulevardin "Aradhat partizane" në Shkup është plaçkitur me ç'rast janë marrë 130 mijë denarë nga qarkullimi ditor. MPB kumtoi se vjedhjen e ka kryer një person i maskuar i cili duke u kërcënuar me thikë dhe shkop i ka marrë paratë nga e punësuar në kazino. Vjedhja ka ndodhur dje rreth orës 08:50. Po ndërmerren masa për gjetjen e autorit dhe për ndriçimin e rastit. (O.XH)

BILANC NEGATIV I KOMPANIVE SHETËRORE

ME BORXHE

DHE MBIPUNËSIME

Sipas analizave të Qendrës për komunikime qytetare, 31 prej 120 kompanive shtetërore tregojnë bilanc negativ të punës, me humbje totale prej 35.4 milionë euro

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 27 nëntor - Kompanitë në pronësi shtetërore në Maqedoni, vitin e kaluar kanë treguar humbje prej afër 36 milionë euro si dhe kanë dyfishuar numrin e të punësuarve në dhjetë vitet e fundit. Në 129 ndërmarrje publike në tërë Maqedoninë, janë të punësuar 17.872 persona, tregon Regjistri i të punësuarve në sektorin publik. Kjo paraqet një dyfishim të të punësuarve në këto kompani, në raport me dhjetë vite më parë. Sipas të dhënave të Avokatit të Popullit, në vitin 2007, në ndërmarrjet publike kanë qenë të punësuar 8299 persona, që do të thotë dyfishim i tyre në periudhën 2007-2017. Gjithashtu, çdo e katërta kompani ka punuar me humbje në vitin e kaluar. Sipas analizave të Qendrës për komunikime qytetare, 31 prej 120 kompanive shtetërore tregojnë bilanc negativ të punës, me humbje totale prej 35.4 milionë euro.

Sipas ekspertëve ekonomik, rritja kaq e madhe e numrit të të punësuarve në ndërmarrjet publike, nuk ka ndjekur edhe rritjen e cilësisë së shërbimeve, ndërsa sh-

tojnë se një nga zgjidhjet që mund të shqyrtohet është edhe orientimi në ato veprimtari ku ka mundësi ndaj koncesioneve dhe partneritetit privat-publik i mjaft kompanive shtetërore.

"Pushteti në gati 30 vitet e fundit në tërë Maqedoninë shpesh ka punësuar kadro partiak nëpër ndërmarrjet publike që shërbejnë shpesh edhe për zgjidhjen e çështjeve sociale nëpër komuna të ndryshme, përkundër kualifikimeve dhe përgatitjes profesionale shpesh diskutabile të të punësuarve. Gjithashtu, kemi edhe raste të punës së tyre jo me nikoqirllëk të menaxhuesve të këtyre kompanive dhe vlerësoj se borxhi prej afër 36 milionë euro, është bile edhe më i madh për shkak të mjaft borxheve që nuk janë faturuar", thotë profesori universitar Sami Bislimi.

Sipas tij, edhe kompanitë e tilla nevojitet të orientohen në parimin e ekonomisë së tregut që të punojnë me sukses, pa humbje dhe të udhëhequra nga menaxhment profesional.

"Në radhë të parë, këto ndërmarrje për t'u reformuar nevojitet të rrisin llogaridhënien për të hollat



Në përgatitje e sipër është edhe Ligji i ri për ndërmarrjet publike, të cilat do të kenë obligim ligjor në të ardhmen që në uebfaqet e tyre të publikojnë raportet e miratuara tremujore financiare, që përmbajnë treguesit për punën financiare, llogaritë vjetore dhe raportin për punën e ndërmarrjes publike në periudhën përkatëse

e harxhuara, borxhet, punësimet e kështu me radhë. Së dyti, ia vlen të mendohet për privatizimin e të gjithë ndërmarrjeve publike me përjashtim të atyre që ofrojnë shërbime publike që duhet të jenë të disponueshme për të gjithë. Pra, nevojitet të privatizohen shërbime të tilla si parkingjet, transporti publik, menaxhimi me mbeturinat, por jo edhe ekonomizimi me ujërat, pyjet etj", thekson Bislimi.

Në ndërkohë, edhe përvojat e shteteve të rajonit nuk janë të treguar të suksesshme në menaxhimin me kompanitë publike. Në Kroaci, ndërmarrjet publike në pronësi të shtetit para tre vitesh kanë treguar humbje prej afër 100 milionë euro si rrjedhojë e tepriçës

së të punësuarve, harxhimeve të panevojshme, blerjes së paqes sociale, si dhe humbjeve që akoma i financojnë obliguesit tatimor kroatë, përmes çmimeve më të larta të shërbimeve apo përmes subvencioneve shtetërore, tregon analiza e Shoqatës së obliguesve tatimor "Lipa".

Ekonomistët thonë se jo çdo herë për kompanitë shtetërore vlen rregulli si për kompanitë e tjera në sektorin privat, se rezultatet financiare të një kompanie janë treguesi kryesor për suksesin e tyre, për shkak se shpesh, për reformat e nevojshme, në punën e tyre mungon vullneti politik nga lartë. Gjithashtu ato shpesh ballafaqohen me mungesë investimesh, pajisje të vjetruar, borxhe të akumuluar ndër vite,

kryerjen e punëve me interes publik, për shkak të së cilave shpesh tregojnë humbje apo edhe mbi-punësim, ku shpesh për numrin e tepërt të punëtorëve dhe lëshimin e tyre eventual nga puna, më shumë rëndësi ka momenti social dhe politik se sa ai ekonomik. Vlerësohet se një nga zgjidhjet e mundshme është edhe ajo që praktikohet në shtetet perëndimore të orientimit ndaj metodave të ekonomisë së tregut, edhe pse bëhet fjalë për kompani publike përmes vlerësimit të rezultateve të arritura, përmes analizës së bilanceve të ndërmarrjeve publike, duke ndjekur sistemin e pagave dhe shpërblimeve, numrin e të punësuarve dhe faktin se sa çdo i punësuar është adekuat për atë vend pune.

Në ndërkohë, në përgatitje e sipër është edhe Ligji i ri për ndërmarrjet publike, të cilat do të kenë obligim ligjor në të ardhmen që në uebfaqet e tyre të publikojnë raportet e miratuara tremujore financiare, që përmbajnë treguesit për punën financiare, llogaritë vjetore dhe raportin për punën e ndërmarrjes publike në periudhën përkatëse.

RIPAROHEN EDHE 12 RRUGË, VETËM NJË NË TERRITOR SHQIPTAR

Vetëm rruga Tetovë-Kodra e Diellit, në gjatësi prej 15 kilometrash, është pjesë e projektit të ri të NP "Rrugët Shtetërore", e cila në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit, ka siguruar 14 milionë euro nga Banka Botërore

Shkup, 27 nëntor - Projekt për riparimin e 12 rrugëve rajonale me gjatësi të përgjithshme prej 166 kilometrave filloi Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetë-

rore në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve. Investimi në riparimin e rrugëve paraqet 14 milionë euro, të siguruar nga Banka Botërore. NP për Rrugë Shtetërore tashmë nënshkroi marrëveshje me kompaninë projektuese për përpunim të projekteve konceptuale, të cilat, siç kumtoi Ministria dikasteriale, pritet të përfundohen për katër muaj. Pas përpunimit të projekteve konkrete do të riparohet rruga rajonale Nagoriçpan i Ri - kufiri Pelince, në gjatësi prej 19 kilometrash, rrugët shtetërore Dellçevë-Zvegër, në gjatësi prej pesë kilometrash dhe Strumicë-Novo Sellë-kufiri me Bullgarinë, në gjatësi prej 20 kilometrash. Pjesë të projektit janë edhe rrugët rajonale Jurumleri-Draçevë, në gjatësi prej 5 kilometrave, Kavadar-Rosoman, në gjatësi

prej 11 kilometrash, Dedeli-Furka-Bogdanci-Gjevgjeli, në gjatësi prej 24 kilometrash, Kumanovë-Sveti Nikole, në gjatësi prej 25 kilometrash, Tetovë-Kodra e Diellit, në gjatësi prej 15 kilometrash, Dellçevë-Pehçevë, në gjatësi prej 15 kilometrash, Berovë-Vinicë, në gjatësi prej 7 kilometrash, Manastir-Demir Hisar, në gjatësi prej 10 kilometrash dhe Draçevë-Oreshani-Taor, në gjatësi prej 10 kilometrash.

"Qeveria e Republikës së Maqedonisë është tërësisht e fokusuar në ndërtimin dhe rikonstruimin e infrastrukturës rrugore në Republikën e Maqedonisë, me qëllim që të mundësohet jetë më cilësore e qytetarëve dhe rritje dhe zhvillim ekonomik i vendit", thuhet në kumtesën e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve. (Z.V)

Ftohtë deri të mërkurën, nga e enjtja më ngrohtë dhe me shi

Shkup, 27 nëntor - Mot i ftohtë dhe me erë me reshje të përkohshme të borës së dobët, paralajmëron DPHM për nesër dhe pasnesër. Temperatura minimale e mëngjesit të mërkurën do të ulet deri në minus 10 gradë Celsius, ndërsa ajo e ditës do të lëvizë në interval prej tre deri tetë gradë Celsius. Valë e re e lagështisë me reshje më të rrëmbyeshme të shiut do të ketë nga e enjtja. Në malet më të larta do të ketë edhe reshje të borës. Të enjte do të fryjë erë përkohësisht e përforcuar juglindore, ndërsa e premtja temperaturat e mëngjesit kudo do të jenë nën zero.

Dukuria e uzurpimit të hapësirave publike në Tetovë, është problem që vite me radhë është aktual dhe assesi të gjen zgjidhje. Malli në këtë pjesë të qytetit të Tetovës shkarkohet kur ju konvencionon pronarëve të shitoreve

TROTUARET TË PAKALUESHME

NGARKOJNË-SHKARKOJNË MALLIN NË MES TË RRUGËS



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 27 nëntor - Gjatë dhjetë muajve të kaluar, në Tetovë dhe rrethinë, janë shqiptuar 2158 dënime për parkime të gabuara, ndërsa 1146 vozitës kanë marrë paralajmërim me shkrim. Pjesa më e madhe e veturave të parkuara gabimisht, janë marrë nga shërbimi i merimangës, i cili i ka transportuar në vende adekuate, ndërsa vozitësit janë dënuar me gjoba në të holla. Sipas policisë, veturat kanë qenë të parkuara gabimisht në udhëkryqe, në trotuare dhe në vende të gjelbra dhe kanë penguar zhvillimin normal të këmbësorëve, biçikletave, dhe pjesëmarrësve tjerë në komunikacion. Dënimet për këtë shkelje ligjore sillen nga 25 euro deri në 250 euro. Vitin e kaluar numri ka qenë dyfish më i madh edhe atë, 3343 vozitës kanë marrë dënime, ndërsa 1909 kanë marrë paralajmërim.

Nga ana tjetër, situata me uzurpimin e trotuareve vazhdon të jetë problem permanent në rrugët e Tetovës. Kësisoj, kemi trotuare dhe rrugë të pakalueshme, vetura të parkuara gjithandej, ngarkim-shkarkim i mallit pa respektuar orarin prej orës 19 në mbrëmje deri ora 7 në mëngjes. Mallrat nëpër markete të ndryshme zbarkohen edhe në mes të ditës, ndërsa transportuesit e bllokojnë rrugën dhe më pas krijohet tollovia në rrugët e Tetovës, edhe pse ekziston një vendim i sjellë nga përbërja e kaluar e Këshillit

të Tetovës që ngarkim-shkarkimi i mallit në disa rrugë të qytetit të bëhet me orar të caktuar. Këtë vendim nuk e respektojnë as marketet në rrugën Industriale në Tetovë, e cila më herët njihej si më e lehtë për qarkullim dhe nuk krijohet tollovi, por tash edhe në këtë rrugë, gjysma e saj që të çon për në dalje të Tetovës për në Gostivar është uzurpuar nga kamionët, të cilët shkarkojnë mallin në mes të ditës.

Dukuria e uzurpimit të hapësirave publike në Tetovë, është problem që vite me radhë është aktual dhe assesi të gjen zgjidhje. Malli në këtë pjesë të qytetit të Tetovës shkarkohet kur ju konvencionon pronarëve të shitoreve, edhe pse në letër ka një vendim se kur duhet të bëhet ngarkim-shkarkimi. Kësaj situatë i kontribuon edhe mospasja e një institucioni të vetëm që do të merret me këtë problematikë. Nga Komuna e Tetovës theksojnë se në bashkëpunim me policinë, në këtë

drejtim do të ketë më shumë kontrole që të vendoset një rend dhe standard se kur duhet që malli të ngarkohet apo shkarkohet.

"Ka një vendim të këshillit se kur duhet që të bëhet ngarkim-shkarkimi i mallit. Është e evidente se ky vendim nuk respektohet dhe prandaj shumë shpejt nëpër këto rrugë do të vendosen shenja njoftuese ku do të jetë i shënuar orari se kur pronarët mund të sjellin mallin nëpër marketet e tyre. Në të kundërtën, në bashkëpunim me policinë do të ketë edhe sanksione adekuate. Po ashtu, në bazë të vendimit të këshillit, nëse një pronar kërkon leje të posaçme, inspektoriati do të shqyrtojë kërkesën dhe më pas do të vendos se a do të jap leje që të ngarkojë apo shkarkojë mallin në orarin e kërkuar nëse është e arsyeshme", thonë nga Shërbimi për informim në Komunën e Tetovës.

Qytetarët nga ana e tyre ankohen se në shumë raste duhet

që të zbresin në rrugë pasi që trotuaret janë të zënë nga automjetet e ndryshme. "Gjithandej trotuaret, por edhe rrugët janë të zëna nga vetura të ndryshme të cilët transportojnë mall. Jemi të detyruar që të qarkullojmë në mjedis të rrugës, sepse është e pamundshme të lëvizet në këtë rrugë", thotë Amiri, një banorë afër rrugës Industriale në Tetovë.

Situatë e njëjtë është në rrugët e tjera të Tetovës dhe kjo ka bërë që në shumë rrugë të qytetit të krijohen rende të gjata të veturave, nervozë tek vozitësit dhe kaos. Më vështirë janë rrugët që çojnë për dalje nga qyteti ku janë edhe të vendosura shumica e marketeve. Edhe rruga nga qendra e Tetovës për te stadiumi i qytetit, çdo ditë është i stërngarkuar me automjete të cilët shkarkojnë mall nëpër markete dhe kjo mjafton që kjo rrugë të jetë e bllokuar dhe e vështirë për qarkullim.

Nis projekti "Thuaji JO gjuhës së urrejtjes"

Tetovë, 27 nëntor - Rreth 4.000 nxënës të viteve të para nga tetë shkollat e mesme në Tetovë dhe Gostivar do të përfshihen me aktivitetet nga projekti parandalues - arsimor "Thuaj JO gjuhës së urrejtjes" që filloi të hënën, informoi zëdhënësi i Sektorit për Punë të Brendshme Tetovë, Marjan Josifovski.

Ai theksoi se bartës të aktiviteteve janë Dega për parandalim në SPB Tetovë dhe misioni i OSBE-së në bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale të Tetovës dhe Gostivarit.

"Për klasat e para nga pesë shkollat e mesme të Tetovës dhe tre të Gostivarit të cilët ndjekin mësim në gjuhën shqipe, maqedonase dhe turke do të organizohen ligjëratat të posaçme që do t'i mbajnë nëpunës policor të trajnuar profesionalisht në funksion të përmirësimit të mirëkuptimit mes nxënësve të përkatësishë së ndryshme etnike. Pas përfundimit të ligjëratave si përmbajtje e planifikuar në këtë projekt do të shpallet konkurs për garë në pikturë me temë "Jeto në harmoni me të tjerët", ndërsa veprat e zgjedhura do të prezantohen në ekspozitë të posaçme", tha Josifovski.

Ai theksoi se qëllimi i aktiviteteve nga projekti parandalues - arsimor "Thuaj JO gjuhës së urrejtjes", është ngritja e vetëdijes tek të rinjtë për rëndësinë e tolerancës dhe respektimit në bashkësitë e përziera etnike.

U.D. DREJTORË NË TË GJITHA INSTITUCIONET ARSIMORE

Gostivar, 27 nëntor - Përmes një konference për shtyp, zëdhënësi i Komunës së Gostivarit - Jasin Demiri, i bëri të ditur emrat e ushtruesve të rinj të detyrës drejtor nëpër institucionet përkatëse arsimore të komunës së Gostivarit.

"Tre institucione do të vazhdojnë t'i menaxhojnë ushtruesit e deritashëm të detyrës, ndërsa në shumicën e shkollave tashmë janë emëruar drejtues të rinj. Siç e dini, kryetari i Komunës, Arben Taravari, vizitoi disa nga shkollat dhe mori mendimin e kolektivit, por fakti që disa shkolla nuk arriti t'i vizitojë para se të emërojë ushtrues detyre, nuk do të thotë se ata janë anashkaluar", tha Demiri.

Ai bëri të ditur se të gjithë



ushtruesit e detyrës drejtorë, do të jenë nën mbikëqyrje edhe të komunës, edhe të kolektivit, prindërve dhe nxënësve dhe nëse konsta-

tohet se ata nuk arrijnë të menaxhojnë siç duhet institucionin, në vend të tyre do të emërohen ushtrues të tjerë.

"Ushtruesit e detyrës kanë mandat gjashtëmuor dhe të gjithë ata të cilët me nder dhe me sukses do ta kalojnë këtë fazë, nëse do të konkurrojnë në konkursin e rregullt dhe nëse do t'i plotësojnë kushtet, do të përzgjidhen për drejtor me mandat katërvjeçar, gjithnjë duke i ndjekur procedurat ligjore", nënvizoi zëdhënësi i komunës së Gostivarit.

Në vazhdim të pres konferencës, Demiri i bëri të njohur për publikun emrat e ushtruesve të detyrës drejtor në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, shkollën e ulët të muzikës dhe të Kopshtit të fëmijëve në Gostivar. Drejtues të institucioneve publike arsimore në komunën e Gostivarit do të

jenë: SHF Ismail Qemali - Shpresa Useini, SHF Bashkimi - Vlera Fidani, SHF Goce Dellçev - Sasho Shareski, SHF Mustafa K. Ataturk - Oktaj Nuredin, SHF Çajla - f. Çajlë - Mevlude Saliu, SHF Gjon Buzuku - f. Sërmnovë, Ibish Iljazi, SHF Faik Koncica - f. Debresh - Sanije Durmishi, SHF Përparimi - f. Çegan - Blerim Ameti, SHF Liria - f. Vërtok - Nazlije Islami, SHF Forina - f. Forinë - Zeqie Musliu, Shkolla e muzikës "Enver Stafai" - Betime Jakupi, Kopshti i fëmijëve "Gëzimi fëmijëror" - Natasha Sazdoska, Gjimnazi - Driton Imeri, Shkolla ekonomike - Jovanka Ognjanoska, Shkolla medicinale - Jeton Sulejmani dhe Shkolla teknike - Gajur Izairi.

Çështje sabotimi



Nga Bajram SELMANI



Petro MARKO

Deviza latine *divide et impera* përçaj e sundo më shumë se kurrë është në shërbim animet ndaj njëres palë ose tjetres, duke u thirr në emër të shumicës e të demokracisë, varësisht politikës shtetërore në sundim ose në sundim e sipër o të tjetres pretenduese për sundim, duke mos paraqitur dallim si "sundues"! Falë këtij sabotimi, deri në palcë të ashtit, ndihet diskriminimi rajonal, etnik, social, gjinor e profesional. Pak nga këto grupe e kategori sociale, ndër ne, nuk e kanë ndier thellë në shpirtin e tyre këtë diskriminim çnjerëzor, etnik..., varësisht vetëdijes së ngritur për këtë. Çështja e sabotimit nuk ka si mos të ndihet në shoqëritë multietnike, çdonjëra palë pretenduese sundimi ose pretenduese absolut e sundimit në shtetin dhe e kundërta, shteti në duart e një grupi etnik, sunduesi absolut ushtron pushtetin përmes sabotimit ndaj tjetrit që ndjen se e kërcënon ose rrezikon. Sunduesi në mënyrë të paskrupull të gjitha mjetet e disponueshme i vë në dispozicion (edhe sabotimin!) për ta realizuar jetë-sundimin.

Në shtetet me demokraci të konsoliduar e me institucionet e zhvilluara juridike, çështja e sabotimit është edhe çështje krimi. Sabotimi në jetën shoqërore si krijimtari në kuptimin e përgjithshëm, si aktivitet në kuptimin e krijimit të, të mirave materiale e strategjisë politike për krijimin e mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve, është më i sofistikuar. Është në natyrën e njeriut mundësia për të bërë mirë ose keq, për të qenë i dobishëm ose i padobishëm, për të luftuar për realizimin e të drejtës natyrore ose për t'u pajtuar me statusqon shoqërore. Potencialisht, njeriu disponon mundësinë më shumë për të bërë keq sesa mirë, për t'u pajtuar me statusqon shoqërore sesa ta realizoi lirinë e personalitetin e tij. Rëndom, njeriut prej "sunduesve të tij" i imponohet "rendi kastor", për sa kohë i shërben interesave të tij, me synim për të qenë të përjetshëm, bashkangjitur kësaj imponimit e vetëdijes së ulët kolektive e shoqërore, kulturore e shkencore etnisë së sunduar. Bie fjala, nëse deri dje bëhej luftë për lirinë e mendimit, sot imponohet "vetëcensura"; respektimin e mandatit në çështje udhëheqjeje, sot kemi përjetësinë e mandatit; në emër të demokracisë e afirmimit të vlerave të kulturës, qoftë edhe të një etnie që

nuk është pushteti por herë pjesë (e herë jo!) e pushtetit, e pjesa opozitë e saj çdoherë jashtë pushtetit, bëhet pjesë e përjetshme e "kastës sunduese", brenda grupit etnik në shërbim të etnisë së përhershme sunduese. Kjo çështje sabotimi edhe kalon pa u vërejtur ndër masat e etnisë së sunduar, ose gjoja pa u vërejtur! Të mbështetësh jo vlerat, mediokritetin e antivlerat do të thotë në mënyrë të përhershme të riciklosh kriza, përmbi të gjitha edhe të vetëdijes, njerëzore individuale e kolektive.

Ata që deri dje ishin llogaritur si forcë e errët e së kaluarës, falë sabotimit të madh u kthyen në ideolog partie e të shoqërisë sonë në kohën e tanishme, por me një përvojë më tepër dhe vetëdije trishtuese hakmarrëse ndaj çdo force a faktori me vizion të etnisë së vet, mandej duke e mbushur pjesë tjetër në shërbim të saj me plot "letra false" që ta mbajë të paarsimuar e me vetëdije të ulët, që ti shërbejë qoftë si trup votues ose si masë-turmë e painteresuar e indiferente. Për ndryshe si do shpjegohet fakti se

Në shtetet me demokraci të konsoliduar e zhvilluara juridike, çështja e sabotimit është edhe çështje krimi



shumë "profesionist të arsimuar" janë me letra të tilla; për tjera profesione janë të përgatitur e krejt tjera profesione ushtrjnë; janë me vlerë të ulët arsimore e të kulturës që ditën e parë të marrëdhënies së punës e kanë në "drejtues pune", nëse jo edhe diçka më tepër; janë pasardhësit e prindërve me dosje të trash të ideologjisë së njëmendësisë, dhe ata dhe vetëm ata ligjërojnë lëndët e humane-shoqërore, e të tjera ekzakthe thirrur në "profesionalizmin" e tyre. Bie fjala kemi mjaftë doktor shkencash, të themi edhe të historisë, por në masmedia minutat kryesor për çështje shkencë historie i zë profesionisti i nivelit të ulët! Çfarë sabotimi! Një vetëdije e zgjuar e në shërbim të njeriut e njerëzimit këtë hile të quajtur sabotim, nuk ka sesi të mos e vërej, por vesh për të buçitur, nuk ndesh, bile edhe për sa kohë nuk do të ndesh, mandej edhe falë përparimit të komunikimit të jo personalizuar! Megjithatë, kritika është e mirë, ajo të jep rast të përmirësosh, të ndryshosh në të mirë; të ngjallë shpresën, jetën për një të nesërme shumë më të mirë.

Importimet tona dhe deputetët

Një deputet i ynë shkoi te një dyqan mobilie për të blerë një sallon. Këto mobilie bëhen këtu, janë të forta, të mira e të lira. Deputeti s' kishte pëlqyer plaçkat që i dëftuan.

Dyqanxhiu i kishte lavdëruar këto dhe i kishte thënë se në Shqipëri s'mund të bëhen më të mira se ato dhe fjalimi kishte vazhduar kështu:

Deputeti: — Pffff... S' më pëlqejnë! Më mirë të sjell nga jashtë një sallon.

Dyqanxhiu: — Po ne me se të rrojmë, kur njerëzia të sjellë nga jashtë mobiliet?

Deputeti: — Po unë dua mall të mirë dhe me që s'ka këtu, do ta sjell nga Vjena.

Dyqanxhiu: — S'kini të drejtë, z. deputet. Me të vërtetë, malli i Vjenës është më i mirë se ai i Shqipërisë. Mirëpo, kjo mund të thuhet edhe për... deputetët.

Edhe ne e dimë se deputeti i Anglisë ose i Zvicrës mund të jetë më i mirë se ai i Shqipërisë, por, megjithatë, deputetët nuk i biem nga ato vende dhe kënaqemi me ata që kemi këtu!.. (Botuar më 1935)

NË SHIRITIN E KOHËS

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delgev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 27 nëntor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
 Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndhimëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktorë: Shkëlzen HALIMI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
 E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
 Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Demokracia në rrezik

Nga Sebastiano MAFFETONE



E kam takuar Kevin Spacey në Ravello, ku po xhironte një film lidhur me Al Gore pak më shumë se një muaj më parë. Në atë moment ishte ndoshta aktori më popullor në botë. Tani praktikisht është thuasë asgjësuar. Nuk ka më agjent dhe zyrë shtypi, përzënie nga Netflix (ndoshta personazhi i tij tek seriali House of Cards do të vdesë), deri në një film lidhur me Paul Getty që po interpretonte do të gjirohen skena të reja që i përkasin me një aktor tjetër në vend të tij. Gjithçka në harkun e vetëm pak javëve. Si pasojë e faktit që vetë Kevin Spacey ka ngacmuar seksualisht të rinj të ndryshëm në raste të shumta të jetës. Gjithçka në brendësi të një fushate të mrekullueshme mediatike, e hapur në rastin e producentit amerikan Harvey Weinstein kundër abuzimeve dhe ngacmimeve seksuale. Herën e fundit që kam qenë në Barcelonë më është dukur një prej qyteteve më të qeta, më diellore dhe më të shijshme të planetit. Kurse tani e dimë sesa është kaotike situata me qytetin dhe Kataloninë në agjitacion të përhershëm, me kompanitë e mëdha që kanë selitë e tyre dhe me shtetin spanjoll pothuajse në

uniforme lufte në at territor. Gjithçka brenda pak muajve. Si pasoja që një kërkese për pavarësi e menaxhuar në mënyrë katastrofike si nga katalanasit, ashtu edhe nga shteti qendror. Dy ndodhi këto që në pamje të parë duket se nuk kanë asnjë raport midis tyre. Kështu do të mendojë secili prej jush pasi ka lexuar rreshtat e para e këtij artikulli. Kurse teza ime është në fakt se nuk mund të jemi të sigurt për këtë palidhshmëri reciproke. Ndoshta një lidhje ka dhe përbëhet nga ajo që në anglisht quhet mobocracy (mobokraci), që do të thotë fuqi turme. Tani, mob është fjala që në anglisht përdoret për mafien tonë, për krimin e organizuar, por edhe për të aluduar për një turme përsë largu kërcënuese. Në zhargonin e videolejërave në kompjuter, mob do të thotë ama edhe monstra të vogla, duke ju referuar armiqve të ndryshëm që kërkohet të eliminohen gjatë zhvillimit të një videoleje. Dhe është ky pushtim monstrash që sipas mendimit tim vë në raport me njëra tjetrën dy ndodhi në dukje shumë të ndryshme si rasti i ngacmimeve seksuale dhe revolta katalanase.

Diskutimi im, të kihat parasysh, nuk ka të bëjë me përmbajtjen: ngacmimet

seksuale janë të turpshme dhe, jo domosdoshmërisht në formën aktuale, popujt kanë ndonjë të drejtë të vetëvendosin. Problem është ai i kërkimit të një lidhjeje të ndryshme midis dy këtyre ngjarjeve, të llojit: si është e mundur që opinion publik mund të ndryshojë, nganjëherë edhe në mënyrë marra-mendëse, në harkun e pak orëve? Besoj se përgjigja është në mënyrën me të cilën rrjetet sociale, si "Facebook", "Instagram" dhe "Twitter", influencojnë sistematikisht njerëzit, duke i eksituar dhe duke ua radikalizuar ndjenjat më të thella të tyre. Tashmë ndodh mjaft rregullisht në politikë. Kopertina e "The Economist" e javës së kaluar titullohej "Kërcënimi i rrjeteve sociale për demokracinë". Dhe dimë për dyshimet e influencës së huaj, sidomos nga ana e Rusisë, ndaj fushatës së Trump. Por problem është më i përgjithshëm dhe ndihmon që të shpjegohen shumë ulje ngritje të ndryshimeve të opinionit, nga pranvera arabe tek Brexit. Por fakti nuk ka të bëjë vetëm me politikën e madhe, por edhe me reagimet e përditshme dhe perceptimet e realitetit. Ajo që rrjetet sociale bëjnë nga kjo pikëpamje është se vënë në kon-

Opinion publik, që është baza e demokracisë, ka nevojë edhe ai për kohë, për maturi dhe për reflektim që të jetë i arsyeshëm



takt midis tyre persona që kanë opinion të forta, por jo domosdoshmërisht të bazuar mbi provën e fakteve në tërësinë e tyre, dhe që duan t'i shikojnë këto opinione të konfirmuara, jo të vëna në provë. Fyerja, ekzagjerimi, radikalizimi, ekstremizmi janë format retorike më të përdorura për këtë lloj operacioni. Rezultati konsiston në krijimin e diskontinuiteteve të papritura dhe ndryshimeve të forta të opinionit publik. Si ai i aktorit dhe i rajonit nga ku kemi filluar. Por edhe duke e pranuar qetësisht profilin etik e rivendikimeve specifike të lidhura me to, nuk ka sesi të mos mbetesh i dyzuar nga spostimet e mëdha të opinionit që influencojnë kaq dramatikisht mbi jetët e njerëzve në mënyrë mjaft të shpejtë. Rreziku implicit në fenomen duket qartë. Opinion publik, që është baza e demokracisë, ka nevojë edhe ai për kohë, për maturi dhe për reflektim që të jetë i arsyeshëm. Kur një gjë e tillë nuk ndodh, atëherë kemi një problem të thellë për sferën publike dhe për demokracinë përfaqësuese, cilësia e së cilës varet pikërisht nga funksionimi i shëndoshë i sferës publike.

(Il Messagero)



Nga Petrit KUÇANA

Një rrëfenjë me Jugosllavin në aeroportin e Podgoricës

"Mirëdita. Unë jam Jugosllavi. Mirëerdhët në Mal të Zi dhe faleminderit që zgjodhët kompaninë tonë". Këto ishin këto fjalët e tij të shqiptuara me një anglishte të mirë, ndërsa mbante në duar emrin tim të printuar në një letër A4 në aeroportin e Podgoricës. Ishte më shumë se kuriozitet emri i tij, por ai me buzëqeshje tregon se emri Jugosllav kishte qenë goxha i përhapur, duke shtuar se është një emër që mbahet mend lehtë. Pasi më shpjegoi procedurat e marrjes me qera të makinës së rezervuar online, më tregoi se siguracioni nuk ishte i vlefshëm për në Kosovë por në çdo vend tjetër të rajonit. Teksa prisnim që makina të vinte, ai më tregonte se kishte qenë gjithandej nëpër Shqipëri, se klientët e tij ishin në shumicë dërrmuese shqiptarë, dhe se ishin nga Londra, i vetmi qytet që akoma nuk e kishte vizituar. Duke u përpjekur që të fliste në shqip, (misioni i pamundur) Jugosllavi zgjodhi anglishten për të treguar për miqësitë e tij me shqiptarët, duke theksuar se biletat për në Podgoricë ishin shumë të lira dhe se ja vlente që shqiptarët të vinin këtej, pasi nga "Majka Te-reza" (e kishte fjalën për aeroportin e Rinasit) biletat ishin shumë të shtrenjta

dhe se nga Podgorica për pak më shumë se një orë do isha në Shkodër. Ishte një përjetim nga ata të turbullt në Aeroportin e Podgoricës, kur akoma më tingëllonin fjalët e bashkudhëtarit shkodran të ulur afër sedileve sime, se kishte shumë vite pa qenë në Tiranë, pasi gjithmonë vinte nga Podgorica për të takuar prindërit. Nga rreth dyqind pasagjerë ne arritëm të numërojmë deri në gjashtë "të huaj" pra jo-shqiptarë (me gjithë kundërshtimin e tij se të paktën dy nga këta të gjashtë ishin shqiptarë të Malit të Zi që flasin serbisht). Çuditja e tij nuk qëndronte tek numri i pasagjerëve të huaj, (pra vetëm gjashtë) por se si ishte e mundur që isha në këtë aeroport për herë të parë, pasi Londër-Tiranë ishte e papërballueshme. Ai e kishte bërë këtë zgjidhje (rruftë Rayneri) pasi zakonisht bileta ishte të paktën 200 funta më e lirë dhe se "më mirë bënte sevap" me ndonjë të afërm, sesa t'ua jep të pangopurve politikanë që nuk lejojnë Raynerin apo EasyJet të ulen në Rinas. Shkodrani më tregoi se sidomos gjatë kohës së verës ka edhe shumë shqiptarë të Kosovës që shkojnë drejt në Ulqin dhe se për shumë prej tyre, është më mirë që të vijnë në Podgoricë, sesa të shkojnë në Shkup, pasi edhe atje Aeroporti i Pri-

shtinës deri para pak kohësh nuk kishte lidhje direkte me Londrën. Shkodranja mbizotëronte jo vetëm në fjalor por edhe në targat e makinave që shfaqeshin në aeroportin e Podgoricës, ku duket se gjithçka ishte kthyer në një rutinë për ta. Më kot mundohesh të harrosh radhën për të depërtuar jashtë aeroportit, pasi dukej si një shteg i ngushtë ku vetëm dy policë malazezë vulosnin pasaportat, ku nuk kishte si të mos bënte përshtypje një pamje e madhe reklamuese e Malit të Zi e shkruar tërësisht në kinezçe, ku Rayneri joshës zbarkonte në aeroportin e tërthortë për shqiptarët. Jashtë ambienteve të aeroportit biseda me Jugosllavin bëhej më tërheqëse ndërsa tregonte për çmimin e ulur të makinave me qera (5 ditë 100 funta) dhe se në sezonin turistik kishte çmime të tjera, por që ishte i lumtur me shqiptarët, pasi shpesh lënë edhe ndonjë bashkish. Ai tregonte edhe për pushimet që kishte kaluar në Sarandë, për rrugët e mira në Shqipëri, problemet e parkimit në Tiranë e deri tek shëtitjet e tij, ku nuk kishte pasur vend të Evropës pa shkuar, përveç Londrës ku duhej vizë. Porosia e fundit e Jugosllavit ishte që të isha i kujdesshëm sidomos në Tiranë, pasi ka shumë problem për

parking dhe se çdo dëmtim të makinës do të detyrohej të mbante në garancinë e bllokuar (rreth 700 funta). Edhe pasi lë Podgoricën dhe nise-sh drejt Shkodrës, më kot të kujtohet se janë të paktën kompanitë prestigjioze lowcost që "begenisin" Malin e Zi, por asnjë e tillë në Shqipëri dhe se jo vetëm se nuk ka ndonjë prioritet, por plot dy ministri të diasporës i kemi në dy shtetet shqiptare dhe se mërgimtarët shqiptarë mbesin të harrurit e mëdhenj. Aeroporti i Kukësit mbetet kaq i harruar, ku nuk ka asnjë shkëndijë se diçka edhe mund të bëhet, të paktën si Mali i Zi që ka pak më shumë banorë se gjysma e Tiranës. Edhe më zyrtësi shikon në kthim, kur radhët në doganën e Muriqanit janë kaq të mëdha, që në pikë të mëngjesit, pasi siç na u tha banorët e Shkodrës shkojnë të punojnë andej dhe kthehen në darkë. Ndërmend të bie aforizma se (pse Malazezët e kanë qafën e gjatë? Sepse shikojnë bereqetet shqiptare). Tashmë duket se është e kundërta dhe asgjë nuk po ndryshon. Madje as fjalët e miradisë së Jugosllavit që na thoshte se nëse do të shkonim për pushimet e Vitit të Ri do na shërbente një tjetër "jugosllav", pasi ai do të shkonte me pushime... (shqip)



Ishte më shumë se kuriozitet emri i tij, por ai me buzëqeshje tregon se emri Jugosllav kishte qenë goxha i përhapur, duke shtuar se është një emër që mbahet mend lehtë

RRËFIMI I NEXHMIJE HOXHËS

SI JETON GRUAJA 96-VJEÇARE E ISH-UDHËHEQËSIT KOMUNIST



RRëfimi i rrallë i të vesë së Enver Hoxhës për jetën e saj ndërsa kalon pleqërinë në një shtëpi të thjeshtë në periferi të Tiranës. Njihuni me detajet si jeton gruaja e ish-udhëheqësit komunist dhe si i shtyn ditët 96-vjeçarja

Nga Albert Z. ZHOLI

Në arkivin e më se tremijë intervistave më kishte munguar një intervistë me ish-numrin një të gruas që ka bërë më shumë histori dhe ka ngjallur debate pafund në Shqipëri që nga krijimi i PKSH më 8 nëntor 1941 deri më sot. Nuk e di përse kisha hezituar, por ishte ndoshta dhe mendimi se kishte deklaruar që nuk do të jepte intervistë dhe kjo më kishte stepur disi. Lloj-lloj mendimesh më vinin në kokë për këtë figurë kaq të çuditshme të historisë shqiptare, që me jetën e saj shekullore, ka përbrenda ngjarje dhe histori të pabesueshme. Ishte këmbëngulja e kryeredaktorit të "Albanian Free Press", z. Kurani që të merrja këtë nismë. Në arkivin tim shënoj 8 intervista me ish-anëtarë të Byrosë Politike ku emri i Nexhmije Hoxhës përmendej shpesh. Për të është folur shumë, që nga fjalët më të bukura, por edhe deri në ato më fyeset, por ajo i qëndron besnike idealit të saj duke mos i marrë në konsideratë çfarë flitet. Ajo që e gërryen më tepër qetësinë e saj është hedhja baltë mbi luftën nacional-çlirimtare.

BANESA

Tek rreth-rrotullimi "Shqiponja" fiks në qendër të saj djathtas-anash kur shkon për në Durrës, një rrugicë e ngushtë si rrugicat e vjetra karakteristike të Tiranës, aty ku kanë qenë dikur zyrat e ish-pularisë së Tiranës, në katin e dytë të çon në vendin ku ndodhet banesa ose thjesht, shtëpia ku banon shoqja (siç kërkon t'i flasësh) Nexhmije Hoxha. Ajo është një ndërtesë dykatëshe me tarracë. Ka një oborr të vogël ku me vështirësi parkohen 4 automjete. Ndërtesa ka ngelur ashtu siç ka qenë, e ndërnuar

në kohën e Enverit (siç thonë banorët). Në katin e parë ka 3 familje. Korridor i banesës në hyrje është shumë i gjerë 2.5 metër, në qendër ndodhet dera e një hyrjeje ndërsa në fund majtas ka një kthesë e cila të çon në një korridor ku dallohen tre dyer të tjera (pra tre familje). Në të djathtë të korridorit janë shkallët e gjera që të çojnë në katin e dytë. Plakati e dyshemesë janë po ato të kohës së "xhaxhit", të mëdha, të plasuritura dhe të pamirëmbajtura. Sa ngjitesh në katin e dytë, 5 metra larg kthesës në qendër të korridorit të gjerë ndodhet dera e shtëpisë së Nexhmijes. Dera ka një mbrojtëse të jashtme xhami dhe pastaj dera normale me dërrasë të bërë në vitet e para të demokracisë. Korridor i në hyrje të katit të dytë ka dhe një ballkon të gjerë ku banorët dalin në mbrëmje dhe sodisin ambientin para "Shqiponjës". Në katin e dytë në tavan ka tre llambadarë shumë të vjetër ku asnjëra prej tyre nuk lëshon dritë, llambat janë të djegur. Para derës së hyrjes së Nexhmijes janë dy tavolina me nga 3 karrige plastike ngjyrë kafe (një majtas-një djathtas derës). Si duket këtu qëndrojnë të afërmit apo miqtë kur vijnë në pranverë apo verë për të biseduar në freski. Në murin e korridorit në lartësinë 1.2 metër anash derës, është instaluar zilja elektrike e vjetër. Kur troket derën e shtëpisë ta hap Pranvera vajza e Nexhmijes. Trupgjatë, ajo të prët fytyrëqeshur. Sa hyn të bie në sy një korridor i ngushtë i mbajtur pastër, ku djathtas është një derë e mbyllur, ndërsa majtas, Pranvera të tregon rrugën për të hyrë në dhomën e shoqes Nexhmije Hoxha. Korridor i ishte i lyer me bojë plastike të bardhë dhe me gjithë vjetërsinë e godinës, pastërtia dallohej kudo.



MEMORJA PERFEKTE
Ajo që më bëri përshtypje tek biseda me të ishte kujtesa e saj. Një kujtesë e pabesueshme për një 96-vjeçare. Mund të them se gjatë gjithë bisedës ajo kurrë nuk e përsëriti dy herë një mendim apo ta korigjonte. Disa herë ajo ishte në dakortësi me vajzën e saj Pranverën. Mund të them se biseda me të dhe me Vito Kapon më kanë lënë një hapi për kujtesën. Dy femra që kanë kaluar shumë peripeci në jetë, mes shumë goditjesh por që kanë një forcë dhe kujtesë që do ta kishte zili çdo 50-vjeçar.

DHOMA

Në fund të korridorit, djathtas, një derë e bardhë gjysmë me xham shërben si hyrje për në dhomën e Nexhmije Hoxhës. Sa hap derën, Pranvera na uron mirëseardhjen. Në të djathtë të derës, 2 metra larg saj, afër murit, në një kolltuk të zakonshëm gri në të bardhë qëndron 96-vjeçarja Nexhmije Hoxha. Sa hapet dera, ajo ngrihet paksa në këmbë dhe më zgjat dorën me një buzëqeshje. Pasi takohemi dhe shtrëngojmë duart ajo më afron të ulem. Për disa minuta e pyesim njëri-tjetrin për punën, shëndetin, familjet, fëmijët, zhvillimet e fundit politike. Në të djathtë të kolltukut të saj ndodhet një komodinë ku mbi të shikon, letra, libra, ilaçe, një radio të vogël, stilolapsa dhe një ndriçuese lëvizëse (abazhur). Aty ku mbaron komodinë ndodhet një karrige mbajtëse metalike për ata që kanë vështirësi në lëvizje. Karrigia qëndron ngjitur me derën në hyrje. Para komodinës ndodhet një kalorifer lëvizës i cili ishte i fikur. Para këmbëve qëndron një kolltuk i vogël pa shpinëmbajtëse që shërben për të vendosur këmbët pak

sa lart në raste kur i kërkohet. Rreth 20 cm mbi kokë në mur ndodhet një fotografi e zmadhuar e Enver Hoxhës me përmasa 1.5x1.2 metër. Është bërë në Drilon të Pogradecit dhe që mbahet si një ndër fotot e rralla të Enver Hoxhës që është publikuar kudo në atë sistem por edhe sot. Në të majtë (kur je përballë) të kësaj fotografie gjigante, ndodhen 5 fotografi të përmasave të ndryshme të gjitha në xham me një kornizë të hollë metalike. Në foton e madhe 40x30 cm është gjithë familja Hoxha dalë në ish-shtëpinë të Blloku në vitet '80. Në të janë dallohen fëmijët e tyre me bashkëshortet/bashkëshortin, me nipërit dhe mbesat. Siç thekson Nexhmija ajo kishte qenë fotografia më e dashur për Enverin, por edhe për të. Në të majtë të saj ndodhet një foto e Enverit në zyrën e tij të punës. Poshtë saj një foto me nipërit dhe mbesat. Poshtë fotos së Enverit, një foto e Nexhmijes me mbesën dhe ngjitur saj, një foto tjetër familjare. Në të djathtë, në faqen e murit mbi një komo ndodhen në kornizë xhami, foto individuale të të gjithë fëmijëve por dhe nipërve dhe mbesave kur ishin të vegjël. "E kam gëzuar këtë jetë shumë mes nipërve dhe mbesave", – thotë Nexhmija. "Kam plot 7 nipër dhe mbesa, – vazhdon ajo, – që më kanë mbushur me gëzim dhe kërenari dhe më kanë plotësuar boshllëkun e madh të këtyre viteve". Lart komosë ndodhen dy portrete në vaj të Enver Hoxhës dhe në krah të djathtë të tyre një foto e rrallë e Nexhmije Hoxhës e bërë në vitin 1944 në Bizë të Martaneshit, në bazën ajrore të amerikano-anglezëve. Në krah të saj ndodhet dhe një portret pikture në vaj i Nexhmije Hoxhës kur ishte studente në Institutin femëror "Mëma Mbretëreshë" e bërë në bazë



të një fotoje të saj kur ishte 15 vjeçe. Në këndin e dhomës në të majtë qëndron e varur një tjetër pikturë e Enver Hoxhës të cilën ia kishte bërë një piktor i ri, emigrant në Francë. Në të djathtën time (përballë Nexhmijes) ndodhet një dritare e madhe, e mbuluar me një tyl të bardhë dhe bezhë, ku kishte mundësi drite. Më tej në një taketuke gjendej boceti i skulpturës që ishte vendosur në Gjirokastër, një bocet i bardhë i ruajtur bukur, ku tregohet Enver Hoxha i ulur me një pallto të hedhur krahëve. Në krah të saj një televizor i vogël plazmë, prodhim i vjetër, 20 polsh (inch). Në fund të murit, majtas, ku mbaron tyli, në lartësinë 1.5 metër nga dysheja, ndodhet një foto në xham e Nexhmijes me Enverin, përballë njëri-tjetrit, ulur në karrige, foto e shkrepur në Drilon. Ndërsa mbrapa një bibliotekë e madhe e vjetër ngjyrë kafe, ku dominojnë librat e Enver Hoxhës, por edhe ato të Nexhmijes. Në tavan, një llambadar i thjeshtë ndriçonte dhomën me përmasa 4.5x4 metër katrorë. Në krah të djathtë të kolltukut ku ishte ulur Nexhmija, ndodhet krevati dopio, i Nexhmijes. Një krevat hekuri i thjeshtë, pa kokë dhe fundore, i mbuluar me një batanije ngjyrë kafe dhe bezhë me kvadrate, e pastër dhe në fund të këmbëve qëndronte pulti komandimit të televizorit.

RRËFIMI PËRMES KOMENTIMIT TË FOTOVE DHE PIKTURAVE

Kur e pyes se kush i ka bërë fotografi dhe pikturat, ku janë bërë dhe kohën Nexhmija përgjigjet: "Foton kryesore që kam mbi kokë dhe foton ku është Enveri në Drilon, jashtë, mes burimeve ujore dhe pemëve e ka bërë Sulo Gradeci", – sqaron Nexhmija. Thua se të gjitha fotot e Drilonit dhe në Pogradec janë fotografi të tij. Kryesisht në punë, në pushime apo dhe



LUFTA NACIONALÇLIRIMTARE

Kur biseda jonë erdhi rreth luftës Nacionalçlirimtare, Nexhmija shpesh herë tundte kokën. "Nuk e kuptoj, – thotë, – pse hidhet kaq baltë ndaj kësaj lufte, kur edhe ish-aleatët tanë e vlerësojnë pa masë". Më tej më tregon dhe librin voluminoz (ma dhuron) që ka bërë për këtë luftë heroike. Nuk heziton të thotë se "ajo mbetet lufta më e madhe popullore dhe më e organizuar e popullit shqiptar". Duke u ndalur tregon se "ndjek çdo gazetë që publikon për luftën dhe vlerëson shumë shoqatën Labëria që respekton të rënët por edhe datat më historike të kësaj lufte".

gëzime familjare fotot i bënte Sulo Gradeci. Kjo është fotoja më popullore e tij. Po ashtu dhe shumicën e fotove familjare i realizonte Sulo Gradeci". "Pikturën kryesore vaji me përmasa 70x80 e ka bërë Myrteza Fushekati. Kjo është një ndër pikturat më të bukura që është riprodhuar shumë herë ndërhyr Pranvera. Në këtë pikturë (vaj-kanavacë) Enveri tregon i buzëqeshur në zyrën e punës. Një pikturë shumë popullore dhe e kërkuar". Në krah të djathtë të kësaj pikturë është një pikturë më e vogël të cilën e ka pikturuar Zef Shoshi. "Enveri në këtë foto tregohet me një cigare pranë gojës që e mban me dorën e majtë. Në këtë pikturë (vaj-kanavacë) Enveri ka dalë shumë serioz (ndryshe nga piktura e Myrteza Fushekati) dhe i mendueshëm sërisht me ato flokët që i merr era. Zef Shoshi ka përcjellë një pikturë me ide dhe emocionale. Piktura më shumë i ngjan një psikanalizë të ish-udhëheqësit komunist". Fotoja ku ka dalë pranë një çadre gjatë Luftës së Dytë Botërore, Nexhmija tregon se është bërë në Bizë të Martaneshit, aty ku kishin bazën e tyre misionet anglo-amerikane. Në foto Nexhmija dallohet e ulur pranë çadrës, me flokë të zeza të derdhura mbi supë. Ajo pohon se nuk e mban mend se kush ia ka bërë këtë foto. Por e quan një ndër fotot më të bukura të saj ndaj e ruan me shumë kujdes dhe e ka shumëfishuar. Këtë foto e ka vendosur dhe në librin e saj "Kujtime për luftën çlirimtare". Nexhmija kujton faktin se kjo foto është bërë në vitin 1944 pas Kongresit të PKSH që u mbajt në Helmës të Skraparit. "Pikturën tjetër të vogël 30x30 e ka bërë Kujtim Buza. Një foto ku Enveri tregohet me tiparet e një udhëheqësi të vërtetë. Kujtim Buza ka bërë dhe pikturën ku Enveri tregohet në çadër gjatë luftës". Boceti i skulpturës që ishte vendosur në Gjirokastër, pranë Obeliskut, është realizuar nga "Skulptori i Popullit" Mumtaz Dhrami. Boceti qëndron afër televizorit dhe nga bardhësia ndryshon ngjyrim sipas refleksëve që shpërndan televizori. Boceti është mbajtur me shumë kujdes dhe ndriçon nga pastërtia. "Ky është një nga senet më me vlerë", – sqaron Pranvera Hoxha. Kjo përmendore që ishte në Gjirokastër nuk dihet ku ka përfunduar. "Në dhomën tjetër kemi dhe shumë foto dhe piktura", – thotë Nexhmija, – por këto janë ato që mua më pëlqejnë më shumë dhe që i shoh çdo ditë". Këto foto dhe piktura për të ishin relaksi i disa minutave ditore. Kur zgjohet në mëngjes tregon se gjëja e parë që bën, hedh sytë në këto relike familjare që thotë se e bëjnë më të kthjellët.

ENVERI DHE LABËRIA

Duke qenë se Enveri është nga Labëria dhe e quante veten lab safi Nexhmija ka ndjekur me vëmendje të gjitha aktivitetet e Shoqatës Kulturore Atdhetare Labëria që ajo e quan kryeshoqatë. Madje ajo ka përgatitur dhe një letër falënderimi për këtë Shoqatë e cila ka karakter të theksuar patriotik por edhe mbron dhe nderon luftën nacional-çlirimtare. Këtë letër ajo e ka shkruar me dorë, ku bie



SHËNIMET

Aty mbi komodinë ajo ka letra pambarim dhe stilolapsa. Aktualisht, Nexhmija është autore e 5 librave dhe sipas saj ajo është duke mbajtur shënime të cilat i vijonë në kujtesë herë pas here të cilat nuk janë të botuara. Deri tashmë Nexhmija ka botuar pesë libra publicistikë me kujtime, por si duket, ajo e shikon që ka shumë ngjarje dhe fakte të pa publikuara dhe po punon sistematikisht për hedhjen e tyre në libër. Ndoshta nuk do të jetë befasi kur ajo së shpejti do të hedh në treg librin e saj të fundit me kujtime.



në sy shkrimi i saj i bukur, i qartë dhe pa gabime. Një shkrim tej i lexueshëm dhe korrekt. Në bisedë ajo thekson se Enveri e donte shumë këngën labe por edhe e këndonte çdo mëngjes. Sipas kujtimeve të saj Enveri kur shkante të rruhej patjetër do të këndonte labçe. Dy janë këngët që ai kishte më për zemër: "Çerçiz Topulli më thonë" dhe "Bilbilentë 13 vanë në litarë vetë". Këto këngë i dëgjonte me vëmendje kur i jepte radio Tirana por edhe i kishte të incizuara. Këto këngë sikur i jepnin forcë thotë ajo. Kur ishin gjallë prindërit e Enverit, ai shkante në dhomën e

pritjes së tyre dhe fillonte këndonte me babanë e tij Halilin i cili pëlqente po këto këngë. Halili ja merrte dhe Enveri ja kthente. Aneja dëgjonte dhe kënaqej.

KUR BËHET FJALË PËR KRIJIMTARINË E ENVERIT

Shumë herë kam lexuar në gazeta apo në libra që Enveri nuk dinte të shkruante apo se dhe librat dhe fjalimet ia bënin të tjerët. Kur flitet për krijimtarinë Nexhmija tund kokën duke siguruar se asgjë nuk është e vërtetë për çka flitet, madje edhe nënqesh. Ajo thekson se Enveri çdo gjë e shkruante vetë, madje kur Byroja Politike mori vendim që në punë të vinte me orar të reduktuar, atëherë ai pati dhe prodhimtarinë më të madhe në krijimtari. Kryesisht në këtë kohë, Enver Hoxha shkroi librat me kujtime, "Vite të vegjëlisë", "Me Stalinin", "Dy popuj miq", "Shënime për lindjen e Mesme", etj... Sipas Nexhmijes, dorëshkrimet e Enverit i zbardhte dhe radhiste Haxhi Kroi dhe pastaj i shikonte Sevo Tarifa, por askush nuk ndryshonte mendimet e Enverit. Unë personalisht nuk marr

përsipër të them se kush ka të drejtë dhe me kë është e vërteta, por tek lexuesi i "Albanian Free Press" do përcjell dy fakte interesante: Në bisedën me ish-sekretaren e Enverit në vitet e luftës, Vito Kapo, në një intervistë që i kam marrë ajo është shprehur: "Enveri kur bënte raporte apo fjalime nuk ngecej në asnjë fjalë. M'i thoshte fjalitë kur shkruaja në makinë shkrimi sikur i lexonte diku në letër. Ishte i pagabueshëm në logjikën e fjalive dhe nuk më kthen-te kurrë mbrapa. Unë 34 vjet kam qenë presidente e Bashkimit të Grave. Prandaj shoku Enver më thoshte që ty të kemi për problemet sociale. Përveç kaq, unë isha edhe anëtare e kryesisht të bashkimeve profesionale". Sevo Tarifa (ish-sekretar i Enver Hoxhës) në një intervistë në muajin prill 2017: "Enver Hoxha shkruante bukur, pastër dhe ishte krijues shumë i mirë. Askush nga ne nuk ka shkruar librat e tij, ata libra janë fryt i punës, i dijes, i studimeve dhe kujtesës së tij të shkëlqyer. Ne kur merrnim në dorë librat e tij kishim të drejtë vetëm të bënim korrektime shumë të vogla ndrysa për redaktim mund të bënim fjalë ose data ngjarjesh që nuk përputheshin në koherencë. Dhe këto ndryshime mikroskopike bëheshin duke e vënë atë në dijeni dhe duke bashkëpunuar me historianë. Kujtesa e tij ishte fenomenale pasi ai studionte shumë dhe njihte çdo gjë që ndodhte në botë. Kush thotë që librat e Enverit i kanë bërë të tjerët gënjen veten".

JETËSHKRIMI

Nexhmija Hoxha u lind më 8 shkurt të vitit 1921, në Manastir, por prindërit e saj ishin nga Dibra. Në vitin 1928, familja e saj u shpërngul për t'u vendosur në Tiranë. Shkollën e mesme e kreu në Institutin Femëror Pedagogjik në Tiranë. Pas çlirimit të vendit vazhdoi me korrespondencë studimet e larta në Fakultetin Histori-Filologjik, dega Gjuhë-Letërsi. Ka marrë pjesë në mbledhjen themeluese të Rinisë Komuniste të Shqipërisë, 22-23 nëntor të vitit 1941. Gjatë luftës mori pjesë si delegate në të gjitha konferencat kombëtare si atë të Pezës, Labinotit dhe Përmetit. Pas çlirimit të vendit, ajo kishte kryer funksione të larta partie dhe shoqërore. Në Kongresin e Parë të PKSH-së u zgjodh anëtare e Komitetit Qendror. Për një kohë kishte qenë edhe presidente e Bashkimit të Grave Antifashiste të Shqipërisë. Gjithashtu, ishte përfaqësuese e popullit në Kuvendin Popullor në të gjitha legjislaturat. Ka qenë drejtore e Drejtorisë së Propagandës, Arsim-Kulturës në KQ të PPSH-së. Nga viti 1966 e në vazhdim kreu detyrën e drejtorit të Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH-së. Ka kryer edhe veprimtari studimore dhe publicistike. Ka botuar edhe disa libra. Në vitin 1988 u zgjodh kryetare e Frontit Demokratik të Shqipërisë. Është vlerësuar me 13 dekorata, si dhe Urdhrin "Hero i Punës Socialiste". Me Enver Hoxhën u martua në 1 janar të vitit 1945 dhe sollën në jetë tre fëmijë, 2 djem dhe një vajzë.

(Albania Free Press)

PAGA MESATARE, E PAMJAFTUESHME

Te paga mesatare bruto në Kosovë nga 9 vende, që janë marrë si mostër (ajo e Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi, Bosnje e Hercegovinës, Bullgarisë, Rumanisë dhe Moldavisë), Kosova pozicionohet e katërta për nga lartësia e pagave. Paga mesatare bruto më e larta është në Malin e Zi me 751 euro, derisa më e ulëta është në Moldavi me 271 euro

Brenda katër vjetësh, paga mesatare bruto në Kosovë, sipas të dhënave të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), ka shënuar rritje për 20 për qind. Në vitin 2012, paga mesatare bruto në Kosovë (përfshirë këtu pagat në sektorin publik, privat dhe publiko - privat), sipas ASK-së ishte 431 euro, derisa në vitin 2016 ishte 519 euro që paraqet një rritje prej 88 eurosh. Niveli i pagave më të larta në Kosovë ishte në sektorin e ndërmarrjeve publike, derisa me paga më të ulëta ishte sektori privat. "Paga mesatare bruto në sektorin publik në vitin 2012 ishte 407 euro, derisa në vitin 2016 ishte 525 euro, duke u rritur për 118. Sektori privat, në vitin 2012 kishte një pagë bruto mesatare prej 367 eurosh, kurse në vitin

2016 kishte 371 euro, që u rrit me vetëm 4 euro", thuhet në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Naim Gashi, ekspert i çështjeve ekonomike, thotë për Radion Evropa e Lirë se paga mesatare prej 500 eurosh është e pamjaftueshme për standardin e qytetarëve në Kosovë. "Sa i përket shportës së konsumatorit, rritja e pagave duhet të shkojë proporcional me inflacionin që është në Kosovë dhe me çmimin e mallrave dhe shërbimeve që janë në tregun e Kosovës. Paga mesatare mbi 500 euro nuk është e mjaftueshme për standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës për faktin se 40 për qind e mallrave në Kosovë importohen nga Bashkimi Evropian, janë çmime të BE-së, derisa pagat e Kosovës janë të papërbalueshme për çmime të tilla", vlerëson Gashi. Ai thotë se Kosova ka nevojë për një nxitje edhe më të madhe të zhvillimit ekonomik pasi që, sipas Gashit, vetëm përmes rritjes afatgjatë ekonomike mund të rritet niveli i pagave, të ardhurat kombëtare në përgjithësi, produkti i brendshëm bruto dhe të përmirësohet bilanci tregtar. "Nëse të gjitha këto ndodhin, atëherë vetvetiu do të rriten pagat në Kosovë dhe do të përmirësohet standardi jetësor i qytetarëve", thotë Gashi.



Përfaqësues të bizneseve në Kosovë thonë se në bazë të hulumtimeve që ata kanë bërë, pagën mesatare në Kosovë e kanë rritur pagat e larta të zyrtarëve në institucionet e Kosovës, që marrin rrogë deri në 5000 euro.

Përfaqësues të bizneseve në Kosovë thonë se në bazë të hulumtimeve që ata kanë bërë, pagën mesatare në Kosovë e kanë rritur pagat e larta të zyrtarëve në institucionet e Kosovës, që marrin rrogë deri në 5000 euro. Kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit, Agim Shahini, thotë për Radion Evropa e Lirë se në Kosovë se janë një numër i konsiderueshëm i punëtorëve që marrin paga nën 200 euro. Sipas tij, paga mesatare mbi 500 euro mund të jetë matje reale, por jo e arsyeshme. "Realisht, nëse përfshihen këtu disa organizata buxhetore që kanë paga të mëdha dhe ata punëtorë që marrin paga më pak se 229 euro pagë mesatare, po ashtu kemi mbi 60 mijë persona që marrin pagë minimale nga 130 apo 170 euro, kjo pagë mesatare mbi 500 euro është matje reale, por jo e arsyeshme", thotë Shahini. Te paga mesatare bruto në Kosovë nga 9 vende, që janë marrë si mostër (ajo e Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi, Bosnje e Hercegovinës, Bullgarisë, Rumanisë dhe Moldavisë), Kosova pozicionohet e katërta për nga lartësia e pagave. Paga mesatare bruto më e larta është në Malin e Zi me 751 euro, derisa më e ulëta është në Moldavi me 271 euro.

Vrasësit serbë me pagesë mbjellin frikë nga Ballkani në Afrikë



Gazeta "Blic" e Beogradit, në versionin e saj të shtypur, ka temë speciale vrasësit serbë me pagesë të cilët kryejnë urdhra për vrasje nëpër shtete të botës. Sipas kësaj gazete, vrasësit serbë me pagesë, "zanatin" për vrasje e poqën gjatë luftërave të viteve të 90-ta të shekullit të shkuar nëpër vendet e ish-Jugosllavisë. Në fillim, thotë kjo gazetë, vrasësit për një vrasje merrnin deri në gjysmë milioni euro. Tani çmimi ka rënë dhe për një vrasje mizore, "punëkryesi" merr vetëm 10 mijë euro. Nga vrasjet e tilla ka filluar po mbillet në Ballkan dhe në Afrikë.

Shqiptarët konsumatorët më të mëdhenj të kokainës

Raporti i OKB-së e rendit Shqipërinë në vend të parë me 2.5 për qind të popullsisë që e konsumojnë. Ky raport bazohet në anketimet që i janë bërë personave të grupmoshës nga 15 deri në 64 vjeç

Ndërsa debati publik fokusohet mbi Shqipërinë si vend prodhimi kanabisi ose si tranzit kokaine dhe heroine, askush nuk është marrë me faktin shqetësues se sa drogë konsumohet në vend. Kështu, në mënyrë krejt të papritur zbulohet nga një raport i Kombeve të Bashkuara se Shqipëria mban vendin e parë në botë për konsumimin e kokainës. Raporti është bërë nga Agjencia kundër Drogës dhe Krimin në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Sipas këtij raporti, i cili bazohet në të dhënat e vitit 2014 e rendit Shqipërinë në



vend të parë me 2.5 për qind të popullsisë që e konsumojnë. Ky raport bazohet në anketimet që i janë bërë personave të grupmoshës nga 15 deri në 64 vjeç. Në hartën me të dhëna e publikuar nga Kombet e Bashkuara, rezultoni se Shqipëria ka lënë pas vende tepër të zhvilluar si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me 2.3 për

qind të popullsisë konsumuese apo Britaninë e Madhe që renditet në vendin e tretë. Edhe pse konsiderohet si një ndër drogat më të shtrenjta, kjo nuk i ka penguar shqiptarët që të jenë konsumuesit më të mëdhenj në kokainës në botë. Në raport theksohet gjithashtu se janë persona në moshë të rritur përdoruesit më të mëdhenj

të kokainës, ndërsa të rinjtë më pak. Shifrat janë të krahasuara edhe me të dhënat qeveritare të vitit 2006, ku në Shqipëri rezultoni përdorues të kokainës vetëm 0.78 për qind e popullsisë dhe brenda 8 viteve numri i përdoruesve është katërfishuar. Në anketimin që i është bërë grupmoshave nga 15 deri në 16 vjeç, rezultojnë përdorues 3 për qind e të anketuarve, shifër kjo disa herë më e vogël se e shumë vendeve të tjera në Europë apo më gjerë. Gjithashtu kjo grupmoshë është e prirur drejt drogave sintetike dhe me të lira si kraku por që është njëkohësisht edhe më e dëmshme. Nëse për kokainën Shqipëria është në vend të parë, e kundërta ndodh për përdorimin e kanabisit. Edhe pse konsiderohemi një vend prodhues dhe kjo drogë është e përhapur gjerësisht, shqiptarët nuk janë ndër konsumuesit më të mëdhenj. Për përdorimin e kanabisit Shqipëria ka një prevalencë prej 5.6, që është përgjithësisht më e ulët se një pjesë e madhe e vendeve të Europës Perëndimore, por më e larta në rajon. Rekordin në Europë e mban Çekia me 11.4%, e ndjekur nga Franca me 11.1%, Italia dhe Spanja me 9.2%, Holanda me 8%. Në botë, përdoruesit më të mëdhenj të hashashit janë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me prevalencë vjetore 16.5% dhe Kanada me 14.3%. Në raportin e Kombeve të Bashkuara janë pasqyruar edhe të dhëna sa i përket luftës së qeverisë kundër drogës. Bie në sy që vitet e fundit ka një rritje të ndjeshme të sasisë së drogës që është kapur. Për vitin 2014 raportohet se janë sekuestruar 6870 kilogram, 26.4 kilogram kokainë dhe 55.3 kilogram heroinë. Ndërkohe në viti para 2013 sekuestrimet e drogës kanë qenë të papërfillshme.

DHJETË DITË KOHË MË SHUMË PËR BRITANIKËT



Pas takimit mes kryeministres britanike, Theresa May dhe kryetarit të Këshillit të BE, Donald Tusk perceptimet për stadin e Brexit ishin të ndryshme të premtën (24.11). Tusk u tregua skeptik, nëse pala britanike po bën ofertat e duhura për të iniciuar fazën e dytë të Brexitit. Megjithatë ai theksoi se arritja e një progresi të konsiderueshëm është e mundur në samitin e dhjetorit, por "sfidat e mëdha" mbeten. Në këto fjalë nuk tingëllojnë as entuziazëm e as gjetje e zgjidhjes së duhur. Tani britanikët i kanë edhe 10 ditë kohë për të bërë lëshimet e tyre. Më 4 dhjetor ata duhet ta bëjnë mjaft konkrete, se cilat propozime do t'i ofrojnë BE-së në tryezën e bisedimeve. Por Theresa May u shpreh, se ajo ka "ndjesinë e vërtetë", se të dyja palët do të bëjnë progres deri në këtë kohë. Ka ende probleme në fusha të ndryshme të Brexit, por bisedimet janë zhvilluar në një "atmosferë pozitive" dhe se të dyja palët "duan të ecin përpara së bashku", tha ajo. I hapur mbetet propozimi konkret i britanikëve për

4 DHJETORI PO AFRON...

Në çështjen e Brexit, BE është kaq e bashkuar, saqë një kancelare në detyrë mund të miratojë pa probleme vendimet e përbashkëta, deklaruan diplomatë të BE. Edhe në Berlin ekziston i njëjti qëndrim: Idetë e "Brexitaneve" se mund të përfitohet nga dobësia e qeverisë gjermane janë "absurde", theksoi politikani i Gjellbër gjerman, Reinhard Bütikofer. Në çështjen e kushteve që duhen plotësuar për të "arritur suksese të dukshme" në bisedimet për Brexit ekziston një ujdi e përgjithshme tek të gjitha grupet parlamentare. Ajo që mund thuhet është se 4 dhjetori po afron, dhe ende shumë çështje janë të hapura.

llogarinë e Brexit. Londra është e gatshme t'i ofrojë BE-së miliarda të tjera. Por detajet ende nuk janë sqaruar, si për shembull të drejtat e qytetarëve të BE. E ardhmja e Irlandës po kthehet në një pikë të vështirë negociimi. Qeveria e Dublinit ka ashpërsuar tonin ditët e fundit, dhe ka kërkuar propozime konkrete nga Britania e Madhe se si mund të mënjanohet kufiri në ishullin irlandez. "Për këtë të dyja palët janë në ujdi", tha Theresa May. Qeveritë e Londrës dhe Dublinit janë në kontakt të vazhdueshëm, por detaje ajo nuk dha, ash-

tu si edhe ministri i Brexit, David Davis në muajt e fundit. Qeveria në Dublin ndodhet aktualisht në një krizë të rëndë dhe kërcënon të rrëzohet për shkak të një skandali me policinë. Kjo mund të dobësojë pozicionin e saj negociues në Bruksel, por opozita e vendit thekson, se në çështjen e Brexit janë të gjithë të një mendimi. Për Dublinin ka rëndësi të madhe afërsia sa më e madhe e Irlandës së Veriut me rregulloret e BE edhe pas Brexit. Parimisht rajoni duhet të mbetet në unionin doganor për të mundësuar një shkëmbim të

BE shikon përparime në negociatat për Brexit, por ende ato mbeten një "sfidë e madhe", sipas presidentit të Këshillit të BE, Donald Tusk. BE i jep Britanisë së Madhe edhe 10 ditë për të bërë lëshime



KE akuzon lëvizjet kundër vaksinimit: 5.6 milionë foshnje të vdekura


Lëvizjet kundër vaksinimit, të njohura si "no vax" mbajnë përgjegjësi morale për vdekjen e shumë fëmijëve. Ky është reagimi i ashpër i Komisionerit Evropian për Shëndetësinë, Vytenis Andriukaitis, gjatë një konferencë për shtyp mbi situatën e shëndetësisë në Bashkimin evropian. "Familjet që ua vunë veshin rekomandimeve të "no vax" u detyruan të varrosin fëmijët e tyre. Ata që e kundërshtojnë imunizimin i këshilloj të bëjnë një shëtitje nga varrezat evropiane, ku ka ende varre njerëzish që kanë vdekur në shekullin e nëntëmbëdhjetë sepse nuk kishte vaksina atëherë. Këto lëvizje na çojnë dekada pas, në vitet e obskurantizmit". Duke ngarkuar me faj jo vetëm lëvizjet qytetare kundër vaksinimit, por edhe familjet që e kanë vënë në zbatim këtë kërkesë, vazhdimi i thirrjes së tij është kërkesa për brezat e rinj që të mos neglizhojnë vaksinimin. Një ditë pas reagimit të përfaqësuesit të BE, edhe specialistët në vendin tonë bëjnë apel për vaksinimin e fëmijëve. Edhe pse nuk ka shifra konkrete për jetë të humbura për shkak të mos vaksinimit në vendin tonë, sërish nuk mund të mos merret në konsideratë që vdekjet në moshë të hershme të kenë lidhje me mungesën e vaksinës. Ndërkohë që sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë rreth 5,6 milion foshnje kanë humbur jetën në vitin 2016.

MUGABE MORI 10 MILIONË DOLLARË PËR T'U DORËHEQUR SI PRESIDENT

Zimbabve ka paguar rreth 10 milionë dollarë para të gatshme për të rrëzuar nga pushteti presidentin Robert Mugabe, ndërsa gruaja e tij do të marrë një pension bujar pas vdekjes së tij dhe bizneset e fëmijëve nuk do të preken nga administrata e ardhshme. "Qeveria do t'i japë atij një shumë të madhe prej 5 milionë dollarësh dhe pastaj pjesën tjetër do ta paguaj me këste", i tha një burim i Zimbabwe Independent, ndërsa raporti është konfirmuar edhe media të tjera. "Mugabe do të gëzojë mbulimin e plotë mjekësor, si dhe pagën e plotë mujore. Në rast të vdekjes së tij, gruas së tij do t'i jepet gjysma [paga e tij mujore]". Mugabe, 93-vjeç, aktual-

sht merr një pension vjetor prej 150,000 dollarë, i cili pjesërisht do të trashëgohet nga bashkëshortja e tij 52 vjeçare, Grace Mugabe. Të dy pritet të qëndrojnë në rezidencën Blue Roof në Harare, ndërsa shteti ende paguan të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të sigurisë dhe të stafit për çiftin. Prona e të dy fëmijëve të Mugabes dhe djalit të gruas së tij Russell nga një martesë e mëparshme "nuk do të konfiskohen", raporton Guardian. Familja e zgjeruar e Mugabe zotëron një gamë të fermave të qumështit dhe ka interesa të dukshme në industrinë minerare të vendit. Pavarësisht protestave të opozitës që asnjë politikan nuk duhet të jetë mbi

ligjin, Mugabe dhe familja e tij u është dhënë gjithashtu imunitet nga çdo ndjekje ligjore për veprimet e tij gjatë 37 viteve në detyrë. Presidenti i përkohshëm, 75-vjeçari Emmerson Mnangagwa, i cili ishte një aleat i ngushtë i Mugabës dhe ndihmës për dekada të tëra, ka premtuar të shmangë "hakmarrjen" kundër klanit qeverisës të rrëzuar dhe ka premtuar të zhvillojë zgjedhje demokratike vitin e ardhshëm.



ATA QË BËNË HISTORINË



DELEGATËT NGA PJESA LINDORE E SHQIPËRISË NË KUVENDIN KOMBËTAR TË VLORËS

Roli i atdhetarëve të kësaj pjese të trojeve shqiptare (Maqedonisë veri perëndimore) edhe në organizimin dhe zhvillimin e Kuvendit kombëtar të Vlorës, ka qenë jashtëzakonisht i madh

Kontributi dhe roli i popullit shqiptar përgjithësisht dhe i atdhetarëve shqiptarë posaçërisht, nga Kumanova e deri në Prespë, në ngjarjet dhe zhvillimet që kanë shoqëruar popullin shqiptar është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Në të katër fazat e zhvillimit të Rilindjes me këtë edhe të vetë lëvizjes kombëtare si pjesë e saj, në këto hapësira janë zhvilluar ngjarje dhe zhvillime të ndryshme të cilat kanë kontribuar në avancimin e çështjes shqiptare, duke ndikuar edhe në procesin e përsheptimit të shpalljes së pavarësisë, të trojeve shqiptare. Kujtojmë kryengritjen në krahinën e Dibrës, kundër reformave të cilat do t'i ndërmerre Perandoria Osmane në vitet e 30-ta, të shekullit XIX. Kryengritjen e viteve 1843–1844, të udhëhequr nga Dervish Cara, e cila kryengritje arriti një shtrirje të madhe gjeografike, me çka arrihet të çlirohet edhe qyteti i

Shkupit. Në periudhën e Lidhjes së Prizrenit dhe atë të Pejës roli i atdhetarëve shqiptarë nga kjo pjesë do të jetë gjithashtu jashtëzakonisht i rëndësishëm. Në dekadën e parë të shekullit XX, në këto hapësira do të organizohen e zhvillohen Kongrese të ndryshme, në të cilët do të merren vendime historike, që do të ndikojnë, si në zhvillimin arsimor e kulturor të popullit shqiptar, gjithashtu edhe në organizimin ushtarak. Ngjarjet si, Kongresi i parë i Manastirit, Kongresi i Dibrës, Kongresi i dytë i Manastirit. Çlirimi i Shkupit në gusht 1912, dhe marrëveshja shqiptaro-turke e arritur në këtë qytet, janë ngjarje të rëndësishme të cilat e kanë përsheptuar procesin e shpalljes së pavarësisë të trojeve shqiptare, më 28 nëntor 1912. Roli i atdhetarëve të kësaj pjese të trojeve shqiptare (Maqedonisë veri perëndimore), edhe në organizimin dhe zhvillimin e Kuvendit kombëtar të Vlorës, ka qenë jashtëzakonisht i madh. Në Kuvendin kombëtar të Vlorës, ku kanë marrë pjesë delegatë nga të gjitha trojet shqiptare, kanë marrë pjesë edhe delegatë nga këto hapësira. Si përfaqësues—delegatë më të njohur nga këto hapësira kanë qenë: MEHMET PASHË DERRALLA, VEHBI DIBRA, SHERIF EFENDI DIBRA, ZYHDI BEJ OHRI, DR. MYRTEZA ALI STRUGA, NURI SOJLIU, HAMDI BEJ OHRI, MUSTAFA BARUTI, DERVISH HIMA.

MEHMET PASHË DERRALLA u lind në fshatin Gradec të Gostivarit,

në vitin 1843. Mësimet e para i mbaron në vendlindje, shkollën e mesme e mbaron në Shkup, ndërsa studimet e larta i ka mbaruar në Akademinë Ushtarake të Stambollit. Që në moshë të re është inkudruar në aktivitete të ndryshme të organizuara nga Lëvizja kombëtare shqiptare, duke bashkëpunuar me Rexhep Pashë Matin, Ismail Qemalin e Hasan Prishtinën. Në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, nga organet drejtuese të saj është ngarkuar me detyrën e komandantit të fuqive ushtarake për Tetovën dhe Gostivarin. Janë të njohura sukseset e tija në luftë kundër ushtrive të Dervish Pashës, në rajonin prej Tetove deri në Shkup. Mehmet Pashë Derralla, është njëri ndër themeluesit e Lidhjes së Pejës, apo Lidhjes Besa-Besë. Nga organet drejtuese të kësaj lidhje, ai caktohet si udhëheqës i organizimit të tubimeve për qytetin e Prizrenit, Gostivarit, Kërçovës, Dibrës, e Ohrit. Mehmet Pashë Derralla, njihet si njëri ndër delegatët kryesor të Kuvendit kombëtar të Vlorës. Në dokumente të kohës dëshmohet pjesëmarrja e tij në Kuvendin kombëtar të Vlorës, bashkë me atdhetarë të njohur, ku theksohet, "si delegatë të ri erdhën z. Mehmet Pashë Derralla, Isa Boletini, Ajdin Draga, Dervish bej Ipeku nga Kosova." Memhmet Pashë Derralla, në mbledhjen e 3 dhjetorit 1912, do të zgjidhet ministër i Luftës në qeverinë e Ismail Qemalit, ku kontributi i tij në ngritjen e këtij In-

stitucioni ka qenë jashtëzakonisht i rëndësishëm. Mehmet Pashë Derralla, ka vdekur në vitin 1918, ndërsa në kujtesën e popullit ngeli si gjenerali i cili kur nuk u mposhtë nga armiku.

VEHBI DIBRA u lind në Dibër të Madhe, më 12 mars 1867, në një familje të shquar për traditat, atdhetare, fetare e kulturore. Vehbi Dibra pas mësimet të para që i mbaron në vendlindje, vazhdon shkollimin e tij në Universitetin e Stambollit për teologji Islame. Gjatë studimeve të tij në Stamboll është njoftuar me atdhetarë të njohur si Sami Frashërin, Naim Frashërin, Murat Toptanin, Hamdi Ohrin, Shahin Kolonjën, etj. Falë kontributit të tij të jashtëzakonshëm në zhvillimet që ishin zhvilluar në trojet shqiptare të udhëhequra nga Lëvizja kombëtare shqiptare, bëri që Vehbi Dibra të ishte njëri ndër delegatët kryesor në Kuvendin kombëtar të Vlorës. Në dokumente të kohës theksohet "dora e tij bashkë me dorën e Ismail Qemalit ngritën flamurin e independencës, në Vlorë." Në mbledhjen e 4 dhjetorit 1912, Vehbi Dibra zgjidhet Kryetar i Senatit shqiptar, qeveria shqiptare e ngarkon me detyrën e krijimit të Komunitetit Mysliman shqiptar, duke e shkëputur atë nga kleri mysli-man i Perandorisë Osmane, kryetar i të cilit Komuniteti zgjidhet po Vehbi Dibra. Vehbi Dibra ka vdekur më 24 mars 1937, në qytetin e Tiranës.


SHERIF DIBRA u lind në Dibër

të Madhe, në vitin 1877. Rrjedh nga një familje atdhetare, gjyshi i tij, Selim bej Rusi, ka qenë i inkudruar herët në Lëvizjen kombëtare. Sherif Dibra pasi mbaron arsimimin në medresenë e Dibrës, vazhdon studimet në Manastir, për të vijuar në Stamboll, ku ka studiuar për teologjinë islame. Gjatë studimeve të tij në Manastir, ka bashkëpunuar me Hamdi Ohrin, Zyhdi bej Ohërin dhe Hajdar Blloshmin. Zgjidhet delegatë i Dibrës në Kuvendin kombëtar të Vlorës, ndërsa në maj të vitit 1913, nga qeveria e Ismail Qemalit, ngarkohet me organizimin e rezistencës kundër forcave pushtuese serbe për krahinën e Dibrës. Në periudhën e viteve 1938–1941, ka qenë Kryetar i keshillit të ulemave në Shkup, ku pas kërcënimeve me të cilat do të përballët, detyrohet të largohet drejt Tiranës, ku do të zgjidhet Kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar. Ka vdekur më 9 mars 1956.

ZYHDI OHËRI ka lindur, në Ohër në vitin 1870, në një familje të njohur atdhetare. Pas përfundimit të shkollimit në vendlindje, ka vazhduar studimet e tija në Stamboll. Ka qenë bashkëpunëtor i afërt i Ibrahim Temos, Dervish Himës dhe Murat Sojliun. Zyhdi Bej Dibra, në nëntor 1912 është zgjedhur delegatë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës. Fillimisht qeveria e Ismail Qemalit e emron si keshilltar pranë Vehbi Dibrës, ndërsa më vonë ngarkohet me detyrën për të ndihmuar organizimin e administratës të qytetit të Elbasanit. Kontributin e tij, Zyhdi Ohëri e ka dhënë në organizime të ndryshme që janë organi-



Dervish Hima




Hamdi bej Ohri



Mehmet Pashe Derralla




Myrteza Ali Struga



Nuri Sojliu



Vehbi Dibra



Zyhdi Ohri

zuar nga Lëvizja kombëtare edhe pas shpalljes së pavarësisë, ka qenë njëri ndër pjesëmarrësit kryesor në Kuvendin e Lushnjës, në vitin 1920. Zyhdi Ohëri ka vdekur në vitin 1931, në Turqi.

DR. MYRTEZA ALI STRUGA u lind në Dibër, në vitin 1878, shkollën fillore dhe të mesme i ka mbaruar në qytetin e Strugës, ndërsa studimet e larta i vazhdon në Stamboll. Pas mbarimit të studimeve kthehet në qytetin e Strugës, në të cilin qytet ka punuar si mjekë. Në nëntor 1912 ka marrë pjesë në Kuvendin kombëtar të Vlorës. Pas shpalljes së pavarësisë, si një atdhetar i dalluar, nuk është pajtuar me ripushtimin e trojeve shqiptare nga ushtritë serbe, do të bashkohet me forcat atdhetare shqiptare, në luftë kundër forcave serbe, duke mos kursyer edhe mjetet financiare që i ka dhënë në ndihmë të kryengritësve. Ka marrë pjesë në Kuvendin e Lushnjës, në

vitin 1920, si delegatë i Strugës dhe Ohërit. Dr. Myrteza Ali Struga, nga qyteti i Strugës, do të vendoset në Peshkopi, ku prej atje do të vendoset në qytetin e Lezhës, ndërsa në vitin 1935 do transferohet në qytetin e Tiranës, ku pas një sëmundje të rëndë ka vdekur në mars 1937.

NURI SOJLIU u lind në Strugë, në vitin 1872, në një familje me tradita të lashta atdhetare. Pas përfundimit të mësimëve fillestare, ka vazhduar shkollimin e mesëm për financa në Stamboll. Si i ri Nuri Sojliu, është përfshirë në aktivitetet që i ka organizuar Lëvizja kombëtare. Ka bashkëpunuar me atdhetarë si: Dervish Himën, Ibrahim Temon, Hamdi Ohërin e Nexhip Dragën. Ka qenë njëri ndër themeluesit e Klubit "Bashkimi", në qytetin e Strugës, njëkohësisht ka qenë edhe sekretar i atij Klubi. Ka qenë pjesëmarrës në Kuvendin kombëtar të Vlorës, më 28 nëntor 1912, si delegatë i

Strugës. Ka vdekur në Strugë në vitin 1940.

HAMDI BEJ OHËRI u lind në Ohër, më 4 shkurt 1872. Pas mësimëve të para që i ka mbaruar në vendlindje, ka kryer Akademinë ushtarake në Stamboll. Si nip i Iliaz Pashë Dibërës, do të afrohet e do të bashkëpunon me atdhetarë të shquar si Naim Frashërin, Ibrahim Temon e Dervish Himën. Në Stamboll, është njohur si "nxënisi i përkëdhelur i Naim Frashërit." Për shkak të aktivitetit të tij, do të dënohet disa herë nga autoritetet Osmane. Fillimisht është dënuar me 5 vite burg, ndërsa më vonë ndaj tij, shqiptohet edhe dënim me vdekje. Në Kuvendin kombëtar të Vlorës, ka qenë përfaqësues i Ohrit dhe Strugës. Ka vdekur më 24 nëntor 1938, në Tiranë.

MUSTAFA BARUTI u lind në Starovë, në vitin 1896. Pas përfundimit të mësimëve të para në vend-

lindje, ka vazhduar arsimimin e mesëm në Shkup. Ka qenë njëri ndër anëtarët e Klubit "Bashkimi", të Manastirit. Ka bashkëpunuar me atdhetarë të njohur si Hamdi Ohërin, Hajdar Blloshmin, Murat Sojlin dhe Fehim Zavalanin. Në vitin 1912 me kërkesë të Hasan Prishtinës, ka organizuar kryengritjen në malësinë e Kurbinit. Ka marrë pjesë në Kuvendin kombëtar të Vlorës, si delegatë i Starovës dhe Ohërit. Edhe pas shpalljes së pavarësisë, ai ka vazhduar aktivitetet për çështjen kombëtare, duke marrë pjesë në Luftën e Vlorës dhe në shumë organizime e aktivitete të organizuara nga Lëvizja kombëtare.

DERVISH HIMA emri i vërtetë i të cilit është Ibrahim Mehmet Naxhi, u lind në Ohër, në vitin 1872. Mësimet e para i ka mbaruar në qytetin e lindjes, për të vazhduar me arsimimin e tij në qytetin e Selanikut, ndërsa në Stamboll ka mba-

ruar shkollën e mesme ushtarake dhe studimet e larta në "Gjylhane", për mjekësi ushtarake. Dervish Hima si atdhetar i njohur ka kontribuar edhe në zhvillimin e arsimit e kulturës, ka botuar disa gazeta, e një numër të madh të shkrimeve në shtypin e asaj kohe. Ka marrë pjesë në disa prej Kongreseve më të rëndësishëm që i ka organizuar Lëvizja kombëtare. Dervish Hima ka qenë bashkëpunëtor i afërt me Ibrahim Temon, Hoxhë Kadriun, Murat Toptanin, Hamdi Ohërin, Ismail Qemalin e Hasan Prishtinën. Në nëntor 1912, është zgjedhur delegatë i Ohërit, në Kuvendin kombëtar të Vlorës. Aktivitetet e tija Dervish Hima në mbrojtje të shtetit shqiptar i ka vijuar me të gjithë kapacitetin e tij, deri në momentet e fundit të jetës së tij. Ka vdekur më 21 maj 1928, në Tiranë. Pjesëmarrja e delegatëve nga të gjitha trojet shqiptare në Kuvendin e Vlorës, ka qenë një fitore e përbashkët e gjithë popullit shqiptar, për të gjitha forcat që kishin luftuar me pushkë e me penë për çlirimin kombëtar. Shpallja e pavarësisë është një fitore e madhe në luftën kundër sundimit osman dhe kundër politikës anti-shqiptare të monarkive fqinje ballkanike, kundër synimeve e planeve të tyre për copëtimin e Shqipërisë.

(Përgatiti **Baqar NUREDINI**)

TETOVA DIKUR

DRAMA E PARË SHQIPE I SHTIU FRIKËN REGJIMIT MONARKIST

Ismail ARSLLANI

Pas ardhjes së Hamit Shijakut në Tetovë, një atdhetar i shquar nga Shqipëria, në prill të vitit 1939, kur italianët okupojnë Shqipërinë, nën përkujdesjen e Organizatës ilegale kombëtare "Besa" të Tetovës, fillon përgatitja e dramës "Të burgosurit". Përfaqësuesi i "Besës", Idriz Ibrahim-Cërcëri bën një marrëveshje me avokatin Kadri Saliu nga Gostivari, që të marrë në "mbrojtje" anëtarët e grupit të dramës të Organizatës ilegale "Besa", po që se shteti, policia dhe strukturat e tjera bëjnë ndonjë represion ose i burgosin aktorët e shfaqjes, ky avokat i njohur të marrë përsipër mbrojtjen, duke angazhuar edhe dy avokatë të tjerë prej Shkupi. Pas këtyre parapërgatitjeve, Organizata "Besa" jep "sinjalin e gjelbër" për fillimin e ushtrimeve, të cilat u zhvilluan në shtëpinë e Hysein Xhaferit /baba i Arbën Xhaferit/në Tetovë. Drama "Të burgosurit", autor i së cilës ishte Hamit Shijaku, trajtonte luftën heroike të popullit shqiptar të malësisë së Shkodrës nën udhëheqjen e Hodo Pashës, i cili kishte luftuar kundër fqinjëve grabitqarë serbo-malazezë. Organizata "BESA" i siguroi Hamit Shijakut një banesë me qira, si dhe ushqim ditore të një gjelëtoje, pronë e Mesut Mulla Beqirit nga Tetova. Këto shpenzime i kompensonte organizata nga buxheti i vet, si dhe i jepte atij një shumë të hollash për shpenzimet personale.

Sipas mësuesit Shefqet Sulejmani nga Tetova, i cili kishte mbajtur njëfarë ditari për këto ngjarje të rëndësishme të para Luftës së Dytë Botërore e më vonë /kopjen e së cilës, derisa ishte gjallë, në vitin 2007 i dha autorit të këtij shkrimi/, ushtrimet për përgatitjen e dramës



Premiera e dramës "Të burgosurit" është dhënë më 7 tetor të vitit 1939, në shtëpinë e Mehmet Bej Palloshit në Tetovë, ku ka pasur një numër shikuesish, aq sa lejonte hapësira

"Të burgosurit" vazhdonin më një intensitet të madh. Për afër dy muaj, përgatitja e dramës ishte gati, ndërsa Naxhi Sulejmani nga "Besa" ishte caktuar përgjegjës i shfaqjes, ndonjë aktorët nuk e dinin këtë. Hamit Shijaku shumë shpesh takohej dhe bisedonte fshhtë me ndonjërin nga anëtarët e "qendrës", si me Idriz Cërcërin, Hysein Xheferin dhe Naxhi Sulejmanin. Në të shumtën e rasteve ka qenë i pranishëm edhe Shefqet Sulejmani. "Nuk kisha mjaft njohuri se si përgatitet një dramë, por përcillja porosinë e organizatës se ku, në cilin termin dhe në cilën shtëpi do të mbaheshin provat e dramës. Vërtet isha i mahnitur me aktorët e dramës dhe kujtoj ato momente

dhe ato skena, që më kanë mbetur të freskëta", kishte shënuar në kujtimet e veta, Shefqet Sulejmani. Premiera e dramës "Të burgosurit" është dhënë më 7 tetor të vitit 1939, në shtëpinë e Mehmet Bej Palloshit në Tetovë, ku ka pasur një numër shikuesish, aq sa lejonte hapësira. Skena ka qenë e rregulluar në mënyrë modeste, aktrimi ka qenë në nivel amatorësh, por kënaqësia e publikut kishte qenë mjaft e madhe, ngase për herë të parë shfaqej një dramë në gjuhën shqipe. Pas disa ditëve, organizata "BESA" vendosi që drama "Të burgosurit" të rishfaqet në shtëpinë e Hysein Xhaferit. Atë ditë kanë qenë të pranishëm edhe anëtarët e organizatës, Hafëz Muhamed ef. Xhelili, Mulla Jahja, aktori dhe regjisori i dramës Hamit Shijaku e të tjerë, ndërsa aktorët të kësaj drame ishin: Abdurahman Tresi, Vehab Kadriu, Kadri Sulejmani (në rolin e vajzës Margarita), Xheladin Palloshi, Sherref Kazazi (në rolin e drejtorit të burgut Savo), Naxhi Sulejmani (roje burgu) dhe Hysni Abdullai (nipi i Hodo Pashës).

Disa ditë më vonë, organizata mban një mbledhje, në të cilën ish-

te vendosur që drama "Të burgosurit" të rishfaqet edhe njëherë në Gradec, një fshat mes Tetovës dhe Gostivarit, prej nga rrjedh me rrënjë nëna e Skënderbeut, si dhe të parët e Mehmet Pashë Derallës, i cili ishte ministër i parë i luftës në Qeverinë e Ismail Qemalit. Më vonë drama pati edhe një reprizë në fshatin Shipkovicë të malësisë së Sharrit. Këto shfaqje kanë pasur shumë sukses, ndërsa publiku ka qenë mjaft i emocionuar. Organizata ilegale "Besa", gjatë asaj kohe punonte fuqimisht në qytet dhe në celulat e saj nëpër fshatra. Mirëpo, regjimi i atëhershëm monarkist kishte siguruar disa të dhëna se "po ndodh diçka" në Tetovë, por nuk kishte fakte dhe argumente dëshmuese, për shkak të punës konspirative të organizatës. Pushtetarët e asaj kohe kishin diskutuar për aktivitetin e kësaj organizate, në një mbledhje që ishte mbajtur në sallën e fizkulturës "Sokollana" në Tetovë. Një nëpunës shtetëror, i quajtur Koço Bogojeviç, kishte dalë me një referat, në të cilin ishte shprehur se "pushteti i ka duart e gjata" dhe këshillonte shqiptarët "që të mos punojnë kundër shtetit, se mund të ndëshkohen!"

Katërvjet më vonë, Kryesia e organizatës "Besa" do të angazhojë edhe mësuesin e dalluar nga Elbasani, Qemal Haxhihasani, i cili do të përgatisë një shfaqje. Ai kishte zgjedhur dramën "Lulja e kujtimit" të Foqion Postolit. Premiera e dramës ishte dhënë më 28 nëntor 1943, në Shtëpinë e Rinisë në Tetovë. Në këtë dramë kishin marrë pjesë gati të gjithë anëtarët e organizatës "Besa", ndërsa kishin ardhur për ta parë të gjithë funksionarët e pushtetit vendor. Salla ka qenë e stërmëshur, ndërsa për herë të parë kishin ardhur edhe gratë shqiptare të disa familjeve. Sipas kujtesës së Shefqet Sulejmanit, në këtë pjesë teatrale kishin marrë role të ndryshme të rinjtë Qemal Hajrullahu, Seri Abdylmexhiti, Sherref Kazazi, Sejfulla Sejfullai, Vera Tetova, Burhan Myhedini, Mustafa Kokarçe, Dhimitër Fëllani, Abdurahman Tresi, Kadri Sulejmani, Mesud Musai, Xheladin Palloshi, Adem Kuçi, Nijazi Fanda, Shefqet Sulejmani, Hysni Zejnushi, Abdulla Adilçe, Nazim Sulejmani, Xhabir Reka, Xhabir Toska, Ismail Ismaili, Abdulla Llaballapi, Myntas Feridi e disa të tjerë. Ndërsa, në pranverë të vitit 1944 ishte përgatitur dhe ishte shfaqur me sukses edhe drama "Dibranja e mjerueme" e Haki Stërmillit.

Me shfaqjen e këtyre dramave në gjuhën shqipe, si dhe të aktiviteteve të tjera që po zhvilloheshin në atë kohë, si në Shtëpinë e Rinisë në Tetovë, ku frekuentonin mjaft të rinj tetovarë, sikundër edhe në sallën e Bibliotekës së qytetit, e cila shpesh mbushej me lexues, por edhe në atë të Fizkulturës, që nga agu deri në terr vizitohej për ushtrime disiplinash të ndryshme, ishte ngjallur dukshëm jeta arsimore, kulturore dhe zbatimëse e rinisë tetovare.

PROFIL

Frederik Rreshpja, poeti që jeton ndërmjet yjeve të qiellit

Andreas DUSHI

Para nesh ngrihet si një Himalajë madhështore vargu i lirikës së Frederik Rreshpes, mbase më i madhi lirik shqiptar në poezinë shqipe. Poezia e tij është brilante. Vargjet që të drithërojnë mbartin mbi vete realitetin tronditës të jetës së tij të vështirë, të papajtuashme asnjëherë me të rëndomtën. Poeti Visar Zhiti shprehet për Reshpen: "... ky antikongformist galant". Poezia e tij është një nga shprehjet më të thella të shpirtit poetik në shqip. Ungareti thoshte: "Poezia është poezi, vetëm nëse dikush duke e dëgjuar ndjehet menjëherë i goditur së brendshmi... Eksplorimi poetik është eksplorimi personal i një gjendjeje të vazhdueshme ferri... Vetëm në poezi mund të gjendet liria". Lirika e Reshpes të kujton Ese-


ninin kur thoshte: "Që të jesh poet do të thotë që të plagosësh veten kurdoherë dhe me gjak të ndjenjave tuaja të ledhatosh në shpirt të tjerët". Vargu i Reshpes është kënaqësi që kthehet në dhimbje, është lot që shndërrohet në këngë, ndjesi që bëhet figurë, figurë që kthehet në simbol. Tematika e poezive të tij është përgjithësisht e trishtë, por e realizuar bukur, përmes detajeve të gjetura dhe të dhëna me kursim.

Parafytyrat e lirikave të Reshpes janë "fotografi" marramendëse për të cilat edhe nëse nuk je profesionist i sferës, mund të kapësh lehtë detajin, finesën, shijen, imazhin. Poezia e tij është krejtësisht e "mbytur" në figuracion poetik, që ndonjëherë ngjan si tragjizëm i artit antik grek. Kadare në veprën "Mëngjeset në Kafe Rostand- moti-

ve nga Parisi", shkruan: "Frederik Rreshpja, poet i shumë vargjeve brilante e befasuese...". Edhe kur shkruan për dashurinë e humbur apo të braktisur, Reshpa nuk kalon në dramizëm apo tragjizëm, përkundrazi poezia e tij merr ngjyra malli njerëzor. Poezia e tij del nga shpirti e i flet shpirtit, ashtu siç thoshte Hegeli "vjen nga shpirti dhe ka destinim shpirtit". Ai të kujton endacakun e Ungaretit. Vetmia e tij ishte proverbiale. Ajo ishte e tillë siç thoshte Dymas: "Arti i madh ka nevojë o për vetminë, o për mizerjen, o për pasionin". Reshpa i pati të tria. Dritëhijet më të holla dhe më të thella të shpirtit njerëzor, ai i transfiguronte në art. Në një poezi të ndjerë deri në lodhje, përsërit disa herë si në një refren se është "i mallkuar me art". Ndonjëherë pushoi edhe së mar-

ruri frymë prej tij. Sa rrugëtonte midis yjesh, rilindte përmes vargjesh që e njëzësonin. Nuk mund të kishte në tokë vend për dy palë të tillë poetë, njëri duhej të ikte, natyrisht gjeniu i vargut, Frederik Rreshpja. Donin ta shtypnin, ta deformonin, por në të vërtetë gdhendën tek ai tipare e fizionomi fisnike e trimërore. Ai qante për të tjerët, vetes i luste vdekjen.

Mund ta krahasojmë pa frikë me Bodlerin, Bllejkun, Rembonë. I zaptuar nga poezia, ajo e kapte për dore e s'dihet se ku e çonte. Magma e krijimtarisë së tij është dhimbja. Ai nuk sajoi poezi, poezia materializohej përmes tij. Reshpa është një prej atyre poetëve që nuk kishin lindur për të jetuar në tokë, por ndërmjet yjeve të qiellit. Atij i shkollon me së miri sentenca latine: "Primus inter paris" - I pari ndër të



parët. Reshpa, si thotë edhe Marian Shestani në biografinë kush-tuar këtij të fundit, mbeti deri në fund të jetës në një ngrysje ekonomike e shpirtërore. Ai ishte modest në një kohë që kishte të drejtë ta mbyllte veprën e vet me fjalët e Horacit: "Exegi monumentum" - I ngri-ta vetes monumentin. Ndërsa ne na vjen ndër mend shprehja në latinisht e Krishtit: "Post fatam resurgam" - Pas vdekjes do të ringjallem. Reshpa pas vdekjes u kthye në legjendë. Nderroi jetë në moshën 66 vjeçare, i braktisur dhe në një varfëri të skajshme.

Koha, e martë 28 nëntor, 2017

NUHIU I KËNAQUR ME BARAZIMIN DHE FLET PËR 16-VJEÇARIN

SUHELIN E PËRCJELL NË STËRVITJE, ËSHTË NJË TALENT I MADH



Ardian Nuhiu

Të riun Suhel Muharemi e përcjell në stërvitje, bëhet fjalë për një talent të madh. Vendosa për zëvendësimin e fundit, nuk kisha zgjidhje tjetër në sulm dhe në kontaktin e tij të parë me topin, ai shënoi gol dhe na solli një pikë

Kur mendohej se nuk ka mënyrë se të shmang humbjen, trajneri Ardian Nuhiu në lojë e inkuadroi 16-të vjeçarin Suhel Muharemi, i cili në kontaktin e parë me topin, me një gjuajtje magjike me këmbën e majtë e shpëtoi skuadrën e tij nga disfata

Shkup, 27 nëntor – Skuadra e FC Shkupi arriti një pik të madhe në stadiumin në Manastir, pasi nga një ndeshje pothuajse e humbur, në fund arriti të fitojë një pikë, duke luajtur 2-2. Kur mendohej se nuk ka mënyrë se të shmang

humbjen, trajneri Ardian Nuhiu në lojë e inkuadroi 16-të vjeçarin Suhel Muharemi, i cili në kontaktin e parë me topin, me një gjuajtje magjike me këmbën e majtë e shpëtoi skuadrën e tij nga disfata.

“Të rikthehesh pas 2-0, është

njëjtë si të fitosh tre dhe jo një pikë. Me pak fat në pjesën e dytë kishim mundësi të kalojmë në epërsi nëpërmjet Mbellas dhe Bajrami, por nxituam shumë. E dinim se 2-0 është rezultat i rrezikshëm nga pikëpamja psikologjike dhe për

këtë arsye ne besuam deri në fund. Të riun Suhel Muharemi e përcjell në stërvitje, bëhet fjalë për një talent të madh. Vendosa për zëvendësimin e fundit, nuk kisha zgjidhje tjetër në sulm dhe në kontaktin e tij të parë me topin, ai shë-

noi gol dhe na solli një pikë”, deklaroi Nuhiu. Me këtë barazim Shkupi kompletoi një javë pozitive, pasi fillimisht mundi thellë 4-1 Renovën, luajti baras me “Skopjen” dhe u kthye me një pikë nga Manastiriti. Ndërkohë, të mërkurën në Çair do të luajë përballjen e parë në kuadër të Kupës së Maqedonisë me Vardarin, derisa po me të njëjtën skuadër dhe në të njëjtin stadium, Shkupi do të ndeshet të dielën në kuadër të javës së fundit të sezonit vjeshtor. (B.K.)

De Biazi na bëri ekip, më plotësoi ëndrrën

Etrit Berisha po spikat me Atalantën dhe është një nga pikat më të forta të kësaj skuadre. Portieri i Kombëtares së Shqipërisë e ka lënë pas dëmtimin e pësuar ndaj Evertonit dhe në ndeshjen e kampionatit me Beneventon është i gatshëm, sikurse edhe u shpreh portieri në emisionin “Zona Gol”. Ai foli edhe për rolin e De Biazit në ecurinë e tij në Kombëtare. “De Biazi ka bërë diçka të madhe me Kombëtaren tonë, u mundua të ndërtojë në skuadër dhe e bëri. Personalisht jam i kënaqur dhe mirënjohës për gjithçka ka bërë për mua dhe ekipin. Për mua ka qenë një ëndërr të përfaqësoj vendin. Po të mos ishte ai, nuk do ishte e mundur. Ai më pa, më besoi dhe është një gjë që unë nuk do ta harroj kurrë”, u shpreh Berisha. Ai bëri edhe një vlerësim për Serinë A: “Kampionati italian është jashtëzakonisht i vështirë. Nëse nuk je i përqendruar dhe nuk e kërkon me ngulm fitoren, do jetë e vështirë. Tani ne, edhe pse jemi një skuadër cilësore, kemi lënë pikë. Luajmë në Evropë dhe e kemi pasur pak të vështirë, duke ngecur pak në kampionat. Në lojërat e ardhshme do jemi më mirë



dhe do marrim më shumë pikë. Do jetë një kampionat i vështirë, janë shumë skuadra që luftojnë dhe kjo e ka bërë ligën më të fortë. Deri në fund nuk do të ketë favoritë absolut. Do jetë i bukur të shihet deri në fund”, Përfundoi numri një i kuqezinjve dhe i Atalantës.

Tifozi anglez humb bastin me Nuhiun

Mat Hamilton
@Mat_Hamiltonnn

I will get a Nuhiu tattoo anywhere on my body if he scores an equaliser for us tonight #swfc

10:34 PM - Nov 22, 2017

48 589 983



Dukej një natë katastrofale për Sheffield Uednsdejn pasi po humbiste 2:1 nga Ipswich Taun. Mirëpo trajneri Karlos Karvalhal e bëri një veprim të mençur, duke e futur në fund të lojës Atdhe Nuhiun në fushë, sulmuesin kosovar që nuk shënonte gol për ekipin anglez që nga viti 2016. Dhe në këtë moment tifozi anglez, Mat Hamilton, e bëri një postim në rrjetin social “Twitter” duke vënë bast se nëse përfaqësuesi kosovar shënon gol do ta bëjë atë tatuazh kur të bëhet 18 vjeç. “Do ta bëj tatuazh Nuhiun diku në trupin tim nëse Nuhiu e shënon golin e barazimit për ne sonte”, kishte shkruar tifozi, i cili me këtë rast e humbi bastin pasi sulmuesi shtatgjatë shënoi në fund dhe ia siguroi një pikë Sheffieldit. Dhe tifozi e humbi bastin e tash është zotuar se

do ta përmbushë premtimin e dhënë. Mentalisht, e vetmja gjë që e shpëton Matin është mosha e tij, pasi është nën 18 vjeç dhe në Mbretërinë e Bashkuar është e ndaluar të bëhen tatuazhet nën këtë moshë. Edhe pse deri kur t’i mbushë 18 vjet njerëzit do ta harrojnë premtimin e tij, ai duket i vendosur për ta bërë tatuazhin. Madje ka bërë premtim përmes një tjetër statusi në llogarinë e tij. “Kur t’i mbush 18 vjet do ta bëj tatuazhin e këtij njeriu të madh dhe do ta postoj këtu. Deri atëherë do të mbetet në krye të postimeve të mia për të ma kujtuar”, ka qeshur ai. Cekim, Nuhiu e kishte realizuar një gol edhe në eliminatoret e “Botërorit 2018” për Kosovën në ndeshje me Islandën.

NGA BENZEMA TE ROBINJO

FUTBOLLI DHE SKANDALET SEKSUALE



Më të shumtë janë skandalet që nuk kanë lidhje me kodin penal, kryesisht në Angli, ku "tabloid"-et e famshme janë të mbushura me skandale seksuale. Nga tradhtia e Xhon Terri me të fejuarën e shokut të kombëtares Uejn Brixh te marrëdhëniet seksuale të Rojo (Manchester Junajted) me një trajnere fitnesi, e cila e ka bërë publik lajmin, deri ta tradhtitë e Giggs

Karim Benzema e ka ndjekur Euro 2016 si një tifoz çfarëdo, nga shtëpia. Me ndonjë peng më shumë se një tifoz normal, sepse në fushë, për të mbrojtur ngjyrat e Francës, mund të kishite qenë edhe ai. Por sulmuesi i Real Madrid ka përfunduar jashtë kombëtares për shkak të skandalit ku është përfshirë dy vite më parë. Bashkëkombësi i tij Valbuena kishite xhiruar një video erotike me bashkëshorten e tij dhe Benzema e ka vënë në kontakt me persona që kanë dashur t'i bëjnë shantazh. Kështu, Federata Franceze ka kërkuar përjashtimin e tij nga ekipi i Deshamps. Natyrisht është një çështje e ndryshme nga ajo e De Geas, i cili është akuzuar për abuzime seksuale bashkë me Muniain. Ura lidhëse, sigurisht, është seksi, shkaku kryesor pse shumë lojtarë kanë përfunduar në telashe.

XHONSON DËNOHET ME 6 VITE BURG

Rasti që ka pasur lidhje me Adam Xhohson është mbyllur në mënyrën më të keqe të mundsh-

me për ish-lojtarin e kombëtares angleze, i cili është dënuar me 6 vite burg sepse kreu marrëdhënie seksuale me një vajzë 15-vjeçare. Amantino Mansini, ish-lojtar i Romës, Interit dhe Milanit, e ka përfunduar aventurën e tij në Itali me një dënim prej 2 vitesh dhe 8 muajsh për dhunë seksuale kundër një vajze të njohur gjatë një feste të organizuar nga Ronaldinjo. Akuzat për përdhunim kanë goditur edhe Patrik Klaivert në 1997-ën, pak muaj para kalimit të tij te Milani. Por holandezi është shpallur i pafajshëm kur është vërtetuar se akuzat nuk ka pasur baza. I fundit në radhë ka qenë Robinjo, i cili është dënuar me 9 vite burg nga Gjykata e Milanos, me akuzën se ka përdhunuar në grup një vajzë të shqiptare.

SKANDALET KRYESISHT NË ANGLI

Më të shumtë janë skandalet që nuk kanë lidhje me kodin penal, kryesisht në Angli, ku "tabloid"-et e famshme janë të mbushura me skandale seksuale. Nga tradhtia e Xhon Terri me të fejuarën e shokut



të kombëtares Uejn Brixh te marrëdhëniet seksuale të Rojo (Manchester Junajted) me një trajnere fitnesi, e cila e ka bërë publik lajmin, deri ta tradhtitë e Giggs. Në 2010-ën, në syrin e ciklonit mediatic kanë përfunduar tre lojtarë të kombëtares franceze: Frank Riberi, Sidnej Govu dhe, përsëri, Karim Benzema, për shkak të lidhjes Zahia Dehar, një prostitutë që në kohën kur ka ndodhur ngjarja ka qenë minorene. Në Kupën e Konfederatave të luajtur në 2013-ën shumë lojtarë të Spanjës, pas fitores ndaj Uruguait, që i ka siguruar kualifikimin e "Furive të Kuqe" në gjysmëfinale kundër Italisë, kanë menduar ta festojnë këtë arritje



duke zhvilluar një strip poker në hotel. Alkool dhe prostituta. Gjithçka është publikuar nga mediat.

NUK MUND TË MOS MUNGOJË ADRIANO

Në këtë listë nuk mund të mungojë sigurisht "Perandori", braziliani Adriano, i cili ka organizuar një festë "hot" në Rio me 18 prostituta të marra nga një bordello e Kopakabanas. Pa harruar edhe Ronaldo, "Fenomenin", i cili ka rënë viktimë e shantazhit të tre transeksualëve, që ishin thirrur nga ai duke menduar se ishin prostituta. Mbrëmja nuk ka shkuar siç pritej.

LAJME SHKURT

100 mln euro për merkaton e janarit

Arsenali pritet të nisë një tjetër sulm për të marrë Tomas Lemar nga Monako në merkato e janarit, pasi ofroi rreth 100 milionë euro për shërbimet e tij, gjatë gushtit të kaluar. Londinezët do të marrin një drejtor të ri teknik gjatë merkatos së ardhshme, pikërisht për t'u marrë me këtë operacion. Raul Sanllehi, drejtori aktual i Barcelonës, do të largohet nga "Camp Nou" dhe pasi u përfol se do të shkonte te Manchester Siti, tani ekzistojnë të gjitha mundësitë që ai të shkojë te klubi i Arsene Venger. Nëse marrëveshja do të arrihet, atëherë Sanllehi do të marrë vendimin e Dik Lav, i cili ka qenë negociatori i Arsenal në merkato. "Topçinjtë" e kanë ende të paqartë të ardhmen e Aleksis Sançez dhe Mesut Ozil, që do të jenë të lirë nga çdo lidhje kontraktuale në qershorin e ardhshëm dhe flitet se në orët e fundit ka qenë pikërisht Barcelona që ka bërë një ofertë për Ozil. Barça ka si prioritet blerjen e Kutinjos nga Liverpooli, por nëse nuk do ta realizojë do të marrë Ozil me kosto zero. Në këto kushte, Arsenali ka nevojë të investojë për të marrë dikë që të luaj pas shpinës së qendërsulmuesit. Arsenal u përpoq të blinte Lemar edhe në ditët e fundit të merkatos së verës së kaluar, por pavarësisht se Monako pranoi 100 milionë eurot e ofruara, ishte vetë lojtari që zgjodhi të qëndronte edhe një vit në "Parc des Princes". Gjithsesi, eliminimi i Monako nga Kupat e Evropës dhe pamundësia për të mbrojtur titullin në Ligue 1, duket se do të shtyjnë futbollistin të vihet nën urdhrat e Venger, duke nisur nga muaji janar.

ÇELLSI BËHET GATI TË THYEJË REKORDIN

40 mln euro për një portier!

Çellsin është vënë në gjurmët e portierit të Anglisë dhe Stok, Xhek Butland, sipas asaj që bën të ditur "Daily Mail". Kampionët e Anglisë, të cilët barazuan 1-1 kundër Liverpoolit në ndeshjen e fundit të Premier Ligës, kërkojnë shërbimet e Butland, duke qenë se Thibaut Kurtoa refuzoi të rinovonte kontratën me "blutë" dhe kanë ofruar 35 milionë sterlina, rreth 40 milionë euro. 24-vjeçari Butland, i cili numëron 6 ndeshje si pjesë e "Tre luanëve", e ka ruajtur rrjetën e paprekur në vetëm në dy nga 11 ndeshjet e luajtura në këtë sezon, duke pësuar 22 gola. Portieri, i cili mbërriti në "Bet365 Stadium", në janar 2013, i rritur te Birmingham Siti, numëron 19 ndeshje pa gol, në 62 ndeshje gjithsej për ekipin e drejtuar nga Mark Hjus. Shtypi ka shkruar se Çellsin ka intensifikuar bisedat me Butland, me portierin aktual Kurtoa që refuzoi të fir-

moste kontratën e re me "Stamford Bridge". Real Madridi dhe Paris Sen-Zhermen kanë shfaqur interesimin e tyre për belgun, që do të largohet nga Londra. Nëse transferimi i Butland te Çellsin do të realizohet, atëherë ai do të vendosë rekordin e ri për transferimin e një portieri nga Anglia, që aktualisht mbahet nga Xhordan Pikford, i cili kaloi nga Sanderlendi te Evertoni për 35 milionë euro, verën e kaluar.





TRADHTITË MË TË DHIMBSHME NË FUTBOLL

Juventus ka befasuar Napolin duke paguar klauzolën prej 90 milionë euro të Gonzalo Higuain, i cili nuk është menduar dy herë për t'i thënë po "Zonjës së Vjetër". Një tradhti kjo që akoma i djeg tifozëve të Napolit

Historia e futbollit është e mbushur me transferime të diskutuara dhe të diskutueshme. Disa prej këtyre janë zhvilluar në orët e vona të natës, të tjerë në mes të ditës. Por në të dy rastet këto operacione kanë shkaktuar zemërimin e tifozëve. Po flasim për emra të rëndësishëm, të cilët, shpesh, kanë zgjedhur të kalojnë te ekipi i të njëjtit qytet ose te një rival historik

BAGJO

Një nga këto "tradhti" të mëdha ka qenë edhe ajo e Roberto Bagjos. Deri në atë moment ishte simboli i Fiorentinës, por është shitur tek Juventus pas Italia 1990. Kjo lëvizje ka çuar në përplasje mes dy tifozerive, edhe pse

Publicitet

mes dy ekipeve ka pasur gjithmonë një rivalitet të madh. Ka bërë bujë refuzimi i "Bishtalecit Hyjnor" për të ekzekutuar një penallti kundër Fiorentinës në kampionat.

RONALDO

Në fillim ka qenë Barcelona, më pas Interi në 1997-ën. "Fenomeni" ishte "Fenomen" deri në momentin kur, për shkak të dëmtimeve kryesisht, është blerë nga Real Madridi. Një lëvizje që nuk është pritur mirë nga tifozët e Barçës. Jo vetëm kaq. Në 2007-ën është transferuar te Milani dhe në derbin kundër Interit ka shënuar dhe ka festuar. Një tradhti e vërtetë për tifozët zikaltër.

HIGUAIN

Juventus ka befasuar Napolin duke paguar klauzolën prej 90 milionë euro të Gonzalo Higuain, i cili nuk është menduar dy herë për t'i thënë po "Zonjës së Vjetër". Një tradhti kjo që akoma i djeg tifozëve të Napolit.

PJANIÇ

Ashtu si me Higuain, Juventus ka paguar edhe klauzolën për të marrë Miralem Pjaniç nga Roma. Mesfushori më i mirë i verdhekuqe, ai me këmbët e mira, i cili i ekzekuton goditjet e dënimit si Zhuninjo Pernambukano. Për verdhekuqtë, transferimi i lojtarit më të mirë pikërisht te bardhezinjtë ka qenë një tradhti e vërtetë, e vështirë për t'u gëlltitur.

FIGO

Portugezi Luis Figo ka arritur të realizojë një transferim që konsiderohej i pamundur nga ato anë, domethënë kalimi nga Barcelona te Real Madrid. Sigurisht, në tavolinë ishin 70 milionë euro (shumë për atë kohë), por për katalanasit ajo plagë është akoma e freskët. Veçanërisht për shkak të faktit se Figo ka fituar gjithçka ishte e mundur me fanellën e "Los Blancos", edhe "Topin e Artë".

TEVEZ

Transferimi i Karlitos Tevez nga Junajted te Siti ka shkaktuar shumë diskutime. I transferuar te "Djajtë e Kuq" në 2007-ën, argjen-

tinasi ka fituar një "Champions League" (të vetmen në karrierë) me Junajted dhe dy kampionate. Sherret me Kristiano Ronaldon dhe Fergusonin e kanë shtyrë të marrë vendimin e bujshëm për t'u transferuar te rivalët e Sittit. Një operacion që është realizuar në 2009-ën dhe që ka kushtuar 30 milionë euro.

MIHAJLOVIÇ

Dy vite te Roma nga 1992-shi te 1994-a, për të kaluar më pas te Sampdoria. Por tradhtia e Sinisha Mihajloviç ka ardhur më vonë, më saktësisht në 1998-ën kur ka vendosur të kalojë te Lacio, duke u bërë lider i atij ekipi.

KAPELLO

Nuk është aspak e lehtë të kalosh tek Juventus pasi ke drejtuar për 5 vite Romën. Këtë ka bërë Fabio Kapello, pasi ishte betuar se nuk do të shkonte në Torino për asnjë arsye. Një goditje e dyfishtë për verdhekuqtë, të cilët kanë parë të largohet edhe "Puma" Emerson, lideri i mesfushës, drejt bardhezinjve.

GANZ

"Shënon gjithmonë ai", shkruanin dhe këndonin tifozët e Interit, duke ndjellë golin e Maurizio Ganz. Por pas dy vitesh me zikaltrit dhe shumë golash, sulmuesi friulan ka kaluar te Milani i urryer, duke dhënë kontributin e tij për titullin e fituar në 1999-ën. Nëse nuk është tradhti kjo.

KOLLOVATI

Të largohesh nga ekipi pas gjashtë vitesh të kaluar si protagonist dhe ndërsa ky ekip po bie në Serinë B nuk është maksimumi. Tifozët e Milanit nuk e kanë harruar atë tradhti të Fulvio Kollovatit.

Në 1982-in, i sapo shpallur kampion bote me Italinë, mbrojtësi është larguar nga Milani, me kuqezinjtë që sapo kishin rënë në Serinë B: ka shkuar tek Interi, dhe kjo lëvizje nuk do t'i falet kurrë. Por goli i Hatlej, pikërisht kundër Kollovatit, në derbin e 1984-ës, ka qenë një hakmarrje e vogël.

Busti i ri i Ronaldos bëhet viral

Skulptori i famshëm, José Antonio Navarro Arteaga, paraqiti një bust spektakolar të Kristiano Ronaldos për muzeun e Real Madridit. Busti i ri i KR7 ka 90 centimetra lartësi, peshon 60 kg dhe është bërë i tëri në bronz. Skulptura e yllit të Real Madridit është krahasuar shpejt me bustin e tij të famshëm të bërë nga skulptori portugez Emanuel Santos për aeroportin e Madeiras.



libri i artë
2017/18

udhërrëfyes mjekësi
FAQ. 133

udhërrëfyes mobilie/ndërtimtari
FAQ. 153

KOPJE FALAS
me gazetën Koha
më 2 Dhjetor
(e shtunë)

ZBRITJE DHE GRATISE
24 KUPONË PREMIUM

DY TRUKE QË TA MARRËSH I PARI VALIXHEN TËNDE NË AEROPORT



Kur avioni ulet, jemi gati për të shijuar arsyen e udhëtimit, por fillimisht duhen pritur valixhet. Ndonjëherë duhen pritur shumë minuta. Atyre që nuk duan të humbasin shumë kohë, po u japim dy këshilla sesi valixhja e tyre të jetë e para mbi korridorin rrëshqitës të bagazheve. Mendojmë që jemi duke folur me të gjithë. Një nga këto metoda, është t'u kërkoje personave në check-in, të ngjisin një etiketë për produktet e brishta, në çantën tënde. Çantat me këtë shënim zakonisht ngarkohen më vonë dhe dalin para çantave të tjera. Veç

kësaj, ato dëmtohen më pak. Megjithatë mund të ndodhë që ndonjëherë, këto shënime nuk shihen nga stafi. Një metodë tjetër që sugjeron punonjësi i aeroportit, Thomas Lo Sciuto në Quora, kërkon të jesh personi i fundit në check-in. "Çantat gjithmonë ngarkohen nga fundi, kështu që nëse je në check-in i fundit, çantat e tua do të vendosen të fundit në transportues, do ishin të fundit në

avionin e bagazheve dhe të parat që zbriten." Ti mund ta dish që sistemet e ngarkimit dhe shkarkimit varen nga linjat ajrore, avionët ose skuadrat e administrimit të bagazheve, që janë arsye përse ndonjëherë ata që hyjnë të fundit në check-in, nuk i marrin valixhet të parët. Dy taktika të sigurta për të garantuar që çantat e tua do arrijnë të parat, mbeten të rezervosh një fluturim në klasin e parë ose të anëtarësohesh në ndonjë klub pasagjerësh të shpeshtë për të marrë një shënim të veçantë që do u jepte prioritet çantave të tua.



LËKURA E VËLLAIT BINJAK SHPËTON FRANCEZIN E DJEGUR NË 95% TË TRUPIT

Për herë të parë në historinë e mjekësisë botërore, është shpëtuar jeta e një personi të djegur në 95 për qind të trupit, dhe kjo falë lëkurës së marrë nga vëllai i tij binjak, bëri të ditur spitali Saint-Louis në Paris, ku është kryer operacioni në fjalë. Kjo është hera e parë që është transplantuar lëkura e vëllezërve binjak në një sipërfaqe kaq të madhe të trupit, thuhet në njoftimin e spitalit. Pacienti Franck, i cili tashmë është kthyer në shtëpi ku po rikupërohet, pësoi një aksident në punë në shtator të vitit 2016, ndërkohë që mjekët fillimisht kishin thënë se gjasat për të mbijetuar ishin pothuajse të pashpresa, nga shkak i shkallës së djegieve në trup. Gjatë trajtimit katër mujor, Frank iu nënshtrua 12 operacioneve, gjatë të cilave në tre operacione atij i është transplantuar lëkura e vëllait të tij binjak Erik, të marrë nga kafka, shpina, dhe kofshët. Operacioni i parë i transplantit ishte shtatë ditë pas lëndimit, hera e dytë 11 ditë më pas, dhe intervenimi i tretë ishte 44 ditë pas djegies. "Gjithmonë kemi qenë të afër, por tani jemi akoma më shumë", tha Frank për transmetuesin televiziv BFMTV. Mjekët thonë se trupi i Frankut nuk kishte refuzuar lëkurën, meqë dhuruesi është gjenetikisht identik.

BREDA 2020-S NË SHITJE MAKINA FLUTURUESE



Brenda vitit 2020 kompania britanike 'NeoXCraft' planifikon të prodhojë për shitje një makinë fluturuese, e cila parashikohet të arrijë shpejtësinë maksimale prej 320 km në orë. E nëse dëshironi që ta bëni tuajën,

ju duhet që të kurseni, apo gjeni 2 milionë dollarë. E nëse nuk do ju pëlqejë që të fluturoni atëherë kompania parashikon që 4 pjesët ku do të jenë helikat të shërbejnë edhe si rrota për të udhëtuar si me një makinë normale.

MIRATOHET ILAÇI I PARË DIGJITAL

Institucioni amerikan, Administrata e Ushqimeve dhe Ilaçeve ka miratuar ilaçin e parë digjital për SHBA, i cili do të gjurmohet nëse pacienti i merr ilaçet. I quajtur Abilify MyCite, bën fjalë për një sensor që pihet i cili komunikon nëse është pirë ilaçi nga pacienti. Më pas ajo transmeton të dhënat mjekësore në një aplikacion në smartfon ku pacienti vullnetarisht i kalon në një bazë të dhënash për doktorin e tij, apo persona të tjerë të autorizuar për ti parë, transmeton tch. Abilify është një ilaç që trajton skizofreninë, çrregullimet bipolare, dhe është një shtesë për trajtimin e depresionit. Abilify MyCite ka një sensor me madhësinë e një kokërr rëre

përbërë prej silikoni, bakri dhe magnezit. Kur sensori bie në kontakt me acidin e stomakut aktivizohet një sinjal elektrik që kalon në mënyrë natyrale përmes trupit.



1443 - Gjergj Kastrioti dhe forcat e tij lirojnë Krujën dhe ngritin flamurin në Kalanë e Krujës.

1660 - Formohet Shoqëria Mbretërore e Londrës.

1821 - Panama shpall pavarësinë nga Spanja.

1854 - Ushtria holandeze pengon kryengritjen kineze në Borneo.

1912 - Shqipëria shpall pavarësinë nga Perandoria Osmane.

1916 - Sulmi i parë ajror i Gjermanëve mbi Londër.

1918 - Bukovina votoi për bashkim me Mbretërinë e Rumanisë.

1960 - Mauritania shpall pavarësinë nga Franca.

1964 - Lançohet Mariner 4: testimi i parë për fluturim afër Marsit.

1973 - Samiti i Ligës Arabe në Algjeri njeh Palestinën

1990 - Jep dorëheqje Margaret Taçer si Kryeministër i Britanisë së Madhe e zëvendësuar nga Xhon Mejxhor.


1994 - Norvegjia voton kundër anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

KALENDARI HISTORIK 28 NËNTOR

Prekja e çelikut do të heqë erë e hudhrës dhe qepës nga duart tuaja. Për këtë qëllim, në disa vende shiten enkas disa lloj "sa-punësh" prej çeliku inox.



Nëse kukullat Barbi do të ishin të vërteta, ato do të qenë shumë të dobëta për të patur fëmijë, dhe shumë jo proporcionale për të ecur drejt.



KUR POLICIA NDAL MINISTRIN
Ministri i Brendshëm nisjet në rrugë me veturë dhe e ndal policia.
- Librezën dhe lejen e vozitjes... Ooo, qenkeni ju z. ministër. Më falni, vazhdoni...
- Jo, jo. Veproni ndaj meje si ndaj çdo qytetari!
- Në rregull ministër, futi nja 20 euro në librezë dhe jeni të lirë të vazhdoni...



Çdo njeri duhet të zgjedhë, nëse duhet të ecë në dritën e altruizmit konstruktiv, apo në errësirën e egoizmit shkatërrues.
(Martin Luther King Jr)

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS